



## PROCESVERBAL

I mbajtur me rastin e mbledhjes së 5 (pestë) të rregullt për vitin 2026,të Kuvendit të Komunës së Suharekës

---

**Vendi:** Suharekë

**Zyra:** Salla e Kuvendit të Komunës

**Data:** 30.04.2026

**Ora:** 10:00

---

### Prezentë në takim:

Znj. Sanie Kuçi  
Rexhepaj

Z. Flamur Bytyçi

Znj. Doruntina Zenelaj

Z. Urim Suka

Z. Astrit Salihu

Z. Nexhat Ramadani

Znj. Vlorë Kryeziu

Znj. Dafina Kolgeci

Z. Bexhet Kuçi

Znj. Albulena Kokollari

Z. Edon Sadikaj

Z. Aziz Bytyçi

Znj. Mimoza Bajraktari

Z. Enver Shabani

Znj. Besa Kuçi

Z. Syl Zenelaj

Z. Ilir Voci

Z. Dardan Berisha

Z. Labinot Halitjaha

Znj. Merita Basha

Z. Demokrat Vataj

Znj. Afërdita Morina

Znj. Antigona Zyba

Z. Liridon Fandaj

Z. Qëndrim Elshani

Znj. Laureta Tafaj

Znj. Jehona Rrafshi

Lumi

Të pranishëm tjerë:

Kryetari i Komunës

Media dhe qytetarë

OSCE, LMT, KDI

Znj. Habibe Bytyqi

Z. Xheladin Sadikaj

Takimin e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit z.Bexhet Kuçi,i cili i njoftoi me rendin e ditës.

## REND DITE

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Sqyrtimi i projekt-vendimit për dhënien e pëlqimit për të zhvilluar procedurat përmes konkurimit të hapur për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës;
3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për dhënien e pëlqimit për të zhvilluar procedurat përmes ankandit publik për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës;
4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit për DKA-në;
5. Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit për ndarjen e bursave për nxënës dhe studentë;
6. Shqyrtimi i projekt-vendimit për emërimin e komisionit për shqyrtimin e shpërblimeve “Emblema e artë”, “Skënderbeu” dhe mirënjohjes “13 Qershor”;
7. Shqyrtimi i projekt-vendimit për shqyrtimin e vendimit 01-Nr-410-9873;
8. Shqyrtimi i projekt-vendimit për shqyrtimin e vendimit 01-Nr-410-9874;
9. Shqyrtimi i projekt-vendimit për shfuqizimin e vendimit 01-Nr-016-9866;
10. Shqyrtimi i projekt-vendimit për bartjen e mjeteve vetanake;
11. Informatë për administrimin e buxhetit të Komunës së Suharekës për periudhën janar-mars 2026;
12. Pyetje dhe përgjigje;

**Kryesuesi** - e hedh në votim rendin e ditës.

**Unanimisht Miratohet rendi i ditës**

**Pika 1.Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**

**Kryesuesi** - e hedh në votim pikën 1.

**Unanimisht Miratohet pika 1**

**Pika 2. Sqyrtimi i projekt-vendimit për dhënien e pëlqimit për të zhvilluar procedurat përmes konkurimit të hapur për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës;**

**Kryesuesi** - e elaboron pikën dhe hap debatin.

**Urim Suka** - Kemi kërku disa herë dhe me mirëkuptimin tuaj kërkoj që për secilën pikë ta merr fjalën së pari sponsorizuesi,drejtori.

**Kryesuesi** - drejtori nuk është i pranishëm.

**Liridon Fandaj** - kjo lëndë ka një vit e më shumë që vjen në Asamble dhe duke mos marrë epilog. Jo për fajin e Asamblesë por për fajin e ekzekutivit.Drejtorja në fjalë atëherë dhe sot bjen projekt-vendime dhe nuk i analizon mirë dhe po ashtu edhe komisioni bën vlerësime pa u bazuar në kontrata që janë në atë lokacion.Si rekomandim kisha thënë që komisioni i cili formohet për këtë parcelë duhet ti merr parasysh të gjitha kontratat që kanë ndodh në atë lokacion dhe pronën publike mos ta jep me përqindje qysh ata vendosin por duke u bazuar në dokumente faktike.Gjithëashtu është mirë të mos zvarritet kjo çështje edhe për investitorin sepse edhe atij ju ka blloku projekti.Kërkoj sqarim te neni 3 i këtij projekt-vendimi ku thotë: pas miratimit nga ana e kuvendit të komunës së Suharekës kjo rregullore hyn në fuqi 30 ditë pas dërgimit në organin mbikqyrës.A është vendim apo është rregullore?Nëse është ndonjë lëshim,duhet të përmirësohet.

**Kryesuesi** - është një gabim teknik.Nuk është rregullore por është vendim.

**Urim Suka** - ky projekt-vendim është një histori në vete për shkak të mos përgaditjes si duhet në faza të mëhershme.Është kthi në pikën zero dhe ne e vlerësojmë që është kthi në pikën zero sepse në formën qysh keni tentu me kalu ka qenë formë e keqe dhe nuk e ka mbrojtë interesin qytetar.Ne si LDK meqenëse jemi në fazën fillestare nuk jemi për me pengu këtë çështje por jemi për me dhënë pëlqimin sot që me ndjek procedurën dhe mos me u vonu edhe investitori aty.Drejtori nuk është këtu

edhe për me na dëgju dhe kjo është një lloj tjetër neglizhence. Është mirë të merret parasysh se çka ka ndodh më herët dhe në formimin e komisionit dhe në procedurat tjera. Te caktimi vlerës minimale të thirrja publike kur të bëhet me pas kujdes që interesi publik të mbrohet që në fillim që mos me pas probleme dhe m'u detyru prap mos me votu. Ne si LDK e japim mbështetjen për këtë projekt-vendim.

**Nexhat Ramadani** - ne po e votojmë për 15 deri 99 vite dhe nëse votohet kështu atëherë është e papërcaktuar.

**Kryesuesi** - propozohet për 99 vite. E hedh në votim pikën 2.

## 26 për, 1 kundër, Miratohet pika 2

### **Pika 3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për dhënien e pëlqimit për të zhvilluar procedurat përmes ankandit publik për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës;**

**Kryesuesi** - e elaboron pikën dhe hap debatin.

**Urim Suka** - ne kemi pas me kërku sqarime e detaje nga ana e drejtorit dhe e Kryetarit. Nuk e di këto mungesa të Kryetarit dhe të drejtorit a janë të qëllimshme për me i evitu këto pika por ne si grup kemi shumë pyetje sepse është një projekt-vendim i rëndësishëm që po merret për zonën atje. E dimë që atje për këta gurëthyes ka pas shumë ankesa të banorëve por në anën tjetër është interesi edhe i atyre që operojnë atje dhe i kanë lejet dhe na duhen informatat më të detajizuara dhe me ditë çfarë vendimi po marrim. Zona e cila na ka ardhë për me dhënë pëlqimin, a ka qenë kjo zonë në shfrytëzim më herët apo është për herë të parë? Nëse nuk ka qenë, a është duke e shfrytëzuar dikush atë zonë apo është e lirë?

A është pyet komuniteti aty? A është bërë ndonjë dëgjim publik që m'u dhënë apo jo kjo zonë në shfrytëzim? Duke marrë për bazë vite më herët, unë e kam pa që ata i kanë disa ankesa por unë nuk jam vetëm për ankesa të qytetarëve sepse duhet me u zhvillu edhe ata operatorë që veq janë atje dhe kanë punëtorë. Ne nuk jemi për me pengu. A mund dikush të jep sqarimet e nevojshme apo ne detyrohemi edhe me votu kundër në këtë formë. Te projekt-vendimi u tha sipas HZK-së se çka mundet m'u përdor por këtu te neni po thuhet vetëm për nevoja biznesore. Duhet ta dimë se cili është qëllimi i komunës. Në këtë formë, pa i marrë sqarimet ne votojmë kundër.

**Liridon Fandaj** - neni 1 i këtij aktvendimi nuk e përcakton afatin kohor por thotë 1 deri 15 vite dhe ne duhet ta dimë për sa po e japim. Po ashtu te neni 1 termi nevoja biznesore është shumë i gjërë dhe nuk e dimë për çka praktikisht po jepet kjo. A po jepet për gurëthyes apo po jepet për nevoja tjera biznesore. Te kërkesa, nëse dikush e ka bërë këtë kërkesë duhet me pas titullar se kush e ka bërë këtë kërkesë. A është kërkesë e një biznesi apo e një individi? Drejtori që e ka sjell këtë projekt-vendim nuk ka ardhë me dhënë sqarime dhe ne nuk e dimë për çka kemi me vendos në ankand këtë pronë dhe për çfarë nevoja ka me u dhënë. Neni 14 i ligjit 06 L 92 për dhënie në shfrytëzim dhe këmbim e thotë që dhënia në shfrytëzim duhet të bëhet duke garantuar mbrojtjen e mjedisit dhe interesin e banorëve lokal. Kur e ka sjell këtë kërkesë, a e ka lexu këtë ligj dhe a është duke mbrojtë mjedisin dhe a është interes i atyre banorëve lokal? Atje ka shumë ankesa sepse ata gurëthyes që janë atje, janë duke shkaktuar dëme të mëdha. Ky projekt-vendim nuk është i plotësuar si duhet me ligj dhe me rregullore dhe ai që e ka sponsorizuar, nuk vje këtu me sqaru. Andaj si i tillë nuk kalon.

**Nexhat Ramadani** - edhe unë shpreh shqetësimin për shkak të mos prezencës së Kryetarit dhe drejtorit përgjegjës për këtë projekt-vendim por duke pas parasysh të gjitha vërejtjet që u dhanë që për mendimin tim janë të arsyeshme dhe me qëllim që mos me u pengu procesi i zhvillimit ekonomikë unë propozoj që kjo pikë të mos votohet sot dhe të shtyhet seancën tjetër, të vihet me sqarime dhe nëse është e arsyeshme natyrisht votojmë edhe ne të gjithë sëbashku.

**Flamur Bytyçi** - pyetje për drejtorin e Inspeksionit. A ka pas ankesa prej qytetarëve në lidhje kur është bërë betonimi në atë pjesë dhe për shkak të pluhurit që bëhet dhe cilat janë veprimet që ju i keni marrë?

**Gent Gashi** - po kemi ankesa të vazhdueshme për gurëthyes. Pjesën ku po e kërkon Enisi sh.p.k. është duke e shfrytëzuar. E ka pas në shfrytëzim por ju ka heq. Ka licencë edhe 10 vite tjera dhe vendi ku po e kërkon i ka zyret dhe trafën me rrymë që furnizohet. Në pjesën tjetër e ka guroren në shfrytëzim, ju ka heq dhe prap po kërkon me marrë.

**Flamur Bytyçi** - në bazë të asaj që tha drejtori, parcela qenka duke u shfrytëzuar. Pra, ne po dojmë me legjitimu një diçka që është duke u shfrytëzuar dhe nuk i paguan asgjë komunës.

**Gent Gashi** - ne kemi dal në teren i kemi bë proceset dhe kërkesat i kemi drejtu në Drejtorinë e Minerave në Prishtinë dhe ata pastaj kanë marrë masat e tyre sipas procedurave ligjore.

**Liridon Fandaj** - kjo që e tha drejtori,tani u zbulu ai operatori ekonomikë që ka bë kërkesë.Ky nuk është ankand publik por kjo është kërkesë e një operatori që ai ka me marrë.Realisht ju me letra e keni rregullu që me favorizu atë operatorin,atë që e tha drejtori.Kjo nuk është as e ligjshme,as e natyrshe.

**Visar Kuçi** - unë pajtohem me asambleistët që thanë me mbrojtë mjedisin,pjesën e qytetarëve dhe tani biznesin dhe është fakt që ne mos me dëmtu edhe biznesin.Në mandatin 2017-2021 kjo Asamble i ka vazhdu 10 kontrata për shfrytëzim për 10 gurëthyes.Njërit prej operatorëve gurëthyes ju ka bë një lëshim ku një pjesë e parcelës që e ka shfrytëzu,që e ka pas licencën e gurëthyesit për periudhën 10 apo 15 vite,nuk i ka hy në dhënie në shfrytëzim.Ndoshta ka ndodh një gabim teknik dhe operatori ka kërku prej komunës me bo zgjidhje.Sa i përket detonimeve Ministria e Mjedisit e ka kompetencë dhe është shumë strikte.Sa e di unë për detonime nuk ka lëshu pëlqim Ministria e mjedisit dhe KPM-ja.

**Liridon Fandaj** - tash ne a duhet me ia renovu licencën atij për atë pjesë apo si?Licencat i lëshon ministria dhe ai e paska marrë licencën me një dokument jo valid.Tash na po ia plotësojmë edhe atë pjesën që nuk e ka.

**Visar Kuçi** - është pajis me licencë në kontratën e kaluar.Drejtori tutje jep sqarime.

**Liridon Fandaj** - ajo licencë nuk është valide sepse ai e ka pas licencën vetëm për ushtrim të veprimtarisë por jo për pronën Nëse i ka kalu kontrata e pronës nuk e di si ministria i ka dhënë licencë kur ai nuk e ka pas atë pronë me afat të caktuar.

**Visar Kuçi** - pas kontratës me komunën ndoshta ma mirë kish me qenë periudha e licencimit sa e ke kontratën.Pajtohem por aty në licencë i shkruan edhe sipërfaqja e parcelës.Ai licencën e ka marrë para se m'i dal afati pronës në shfrytëzim. Drejtori tutje jep sqarime.

**Liridon Fandaj** - nuk mundet me dhënë licencë për një diçka që nuk e ka ai.

**Kryesuesi** - ne nuk kemi me u marrë me licencë por ne po mirremi me pronën se a do ta incojmë procedurën apo jo.Si ja kanë dhënë licencën,edhe unë habitem sepse ajo shkon në proporcion me kohën sa e merr por është mirë ti bëjmë zgjidhje.

**Liridon Fandaj** - a pajtohesh që ankandi publik është për të gjithë dhe jo për një operator.

**Urim Suka** - mire që erdh drejtori dhe është mire të jap sqarime.Ai tha që dikush e ka pas më herët në shfrytëzim.Nëse ai dhjet vjetëshi ka skadu,ti duhet me hap procedure tjerër për me marrë.Nëse i ka skadu atij prej vitit 2021 dhe prej vitit 2021 nuk e kemi nis ne si procedure,çdokush që ka punu në atë parcelë,është duke punu në të zezën.Këtu është dasht Drejtoria e Inspeksionit mos me leju me ndodh ato punime por paraprakisht Drejtoria e pronës është dasht me fillu procedure dhe mos me lënë kështu

**Visar Kuçi** - atë pjesën që the kush e ka pas para kësaj kontrate,i njejt operator ka qenë për deri sa ka licencë.Drejtori tutje jep sqarime.

**Urim Suka** - në qoftëse në 2021 është marrë një vendim në kuvendin e komunës për me ja dhënë edhe 10 vite,çfarëdo gabimi teknik që këta e kanë bërë,më s'është problem i komunës.

**Kryesuesi** - kjo që po flasim ne është e lirë.

**Labinot Halitjaha** - tema nuk është a e ka licencën apo nuk e ka,por tema është se a është e rregullt me procedura ligjore për me fillu procedurën.Ne mund ta vazhdojmë procedurën,ka m'u formu komisioni dhe ka me ardhë prap në Asamble m'u votu dhe nëse ka diçka të keqe,nuk e shtyejmë përpara.

**Dardan Berisha** - paraprakisht ne duhet me pas parasysh që në momentin që ka ardhë ky vendim,parcela nuk ka kontratë.Mendoj që dolëm jasht pikes së rendit të ditës sepse ne jemi duke e inicu këtë parcelë me dhënë në shfrytëzim.Për punën e ushtrimit të veprimtarisë unë mendoj që edhe komisioni kur të formohet mund ta ketë parasysh se çfarë veprimtarie ka me ushtru tash e tutje ai biznes.Për me dal prej kësaj situatë dhe m'i dhënë hapësirë asaj parcele,ne duhet me kalu këtë projekt vendim që me dal prej këtij ngërqi.

**Nexhat Ramadani** - çështja e licencës nuk është çështje e jona.Licenca ka të bëj me veprimatrinë.Vendimi i kuvendit të komunës për me u shfrytëzu ajo pasuni është ajo që neve na intereson.Argumentet e grupit tone janë jo me pengu por thjesht a ka pas debat dhe disa sqarime të nevojshme për neve dhe për këtë unë propozova shtyerjen për një muaj.Le ta din edhe ai biznes që të tjerët nuk janë kundër tij por njerëz të papërgjegjshëm,drejtor të papërgjegjshëm,Kryetar i papërgjegjshëm,diçka që e ka pas me vendim kur ia ka bërë kontratën e re,ia ka heq.Unë e kuptoj që është procedurë e re por unë kërkoj të shtyhet seancën e radhës që të sqarohet më mirë dhe të merr drejtimin adekuat.

**Armend Krasniqi** - kemi dal shumë jasht temës.Ligji për dhënie në shfrytëzim të pronave komunale specifikon kur një pronë duhet me u dhënë në shfrytëzim.Ne përtej ligjit e kemi të miratuar edhe HZK-në.HZK e ka parapa që ajo ka destinim të caktuar.Kjo paraprakisht nuk ka pas kontratë në komunë sa e di unë mirëpo ne jemi duke e marrë një vendim vetëm për të inicuar një procedurë për me dhënë në shfrytëzim një pronë komunale.Në bazë të HZK-së,në bazë të interesit të komunës dhe në bazë të intersit të operatorëve ekonomikë apo qytetarëve të Suharekës.Pra,në çdo vendim që e kemi nis,e kemi nis në bazë të kësaj arsyeshmërie dhe për këtë normal që interes duhet me pas komuna.

**Flamur Bytyçi** - Amendi po thotë që s'ka pas kontratë por unë me sa e di ka pas kontratë dhe e përmendi edhe Visari.Pas kohës që i ka skadu kontrata tash e keni sjell përsëri për me dhënë në shfrytëzimA ka pas kontratë kjo në të kaluarën? A është tarifu ky shfrytëzues me tarifën e taksës për rent edhe është pagu renta?Si keni vazhdu me tarifu dikënd për deri sa nuk keni kontratë dhe s'i keni leju me shfrytëzu dikënd që s'ka kontratë?Papërgjegjësia është e juaja dhe figuron në listën e obligimeve të rentës.

**Visar Kuçi** - Armendi e sqaroi për peridhën sa ka qenë drejtor s'ka pas kontratë dhe ne po themi që s'ska pas kontratë sepse kontratat janë vazhdu në vitin 2021 por kjo pjesë drejtori tha s'ka pas kontratë.

**Laureta Tafaj** - A ju pengon juve qytetarëve të asaj zone ai gurëthyes aty drejtor?Të lutem përgjigju si qytetar sepse neve shumë qytetarë të asaj zone na kanë thënë që mos lejoni të ndodh kjo.

**Armend Krasniqi** - në mandatin tim 4 vjeçar janë dhënë prona dhe çdo pronë që është dhënë ka qenë në interes të qytetarëve dhe mbi të gjitha ka qenë në interes të komunës.

**Laureta Tafaj** - para çdo gjëje vjen shëndeti i qytetarëve pastaj interesi i komunës e interesat personale e të gjitha të tjerat.

**Armend Krasniqi** - ne e kemi miratu HZK-në dhe HZK-ja ka parapa të gjitha zonat se si duhet të zhvillohen.Nëse aty u parapa me u ndërtu gurëthyes,apo shkollë,DSHPJ bën inicimin në përpuethshmëri me atë që e ka parapa vet HZK-ja dhe vet asambleistat e drejtorat dhe gjithë qytetarët.

**Liridon Fandaj** - Drejtori i Urbanizmit e ka marrë fjalën për me mbrojtë Drejtorin e Pronës dhe me sqaru por a e dinë që ajo pronë është duke u shfrytëzu edhe sot.Si ka mundësi që po thua që i ke bërë të gjitha gjërat në rregull dhe thua që je ekspert,dikush me shfrytëzu pronën publike dhe ti mos me marrë asnjë masë.

**Armend Krasniqi** - gjatë katër vite të cilat i kam qeverisur unë me drejtorinë e Pronës nuk ka qenë e e uzurpuar asnjë prone komunale gjat katër viteve.

**Liridon Fandaj** - a ti numëroj? Tregu i qytetit,deponia.

**Kryesuesi** - e hedh në votim pikën 3.

**13 për,13 kundër,1 apstenim**

**Kryesuesi e përdor të drejtën e votës së dyfishtë dhe voton për.**

**Miratohet pika 3**

#### **Pika 4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit për DKA-në;**

**Kryesuesi** - elaboron pikën dhe hap debatin.

**Remzi Bajselmani** - sipas rregullores për përzgjedhjen drejtor,zëvendës drejtor DKA obligohet që brenda tri dite pasi të shpallet konkursi të formojë komisionet me vendim për formimin e komisionit dhe i propozon Asamblesë komunale që ta aprovojë.Ne si DKA i kemi kry procedurat komunale duke u bazuar në rregulloren konkrete dhe jemi kujdes që ky komision të jetë sa më profesional dhe i paanshëm dhe i kemi sjell dy emra.Sipa ligjit anëtari i DKA-së është kryetar i komisionit ndërsa personi i dytë që propozohet nga DKA është drejtor shkolle që DKA ka konstatu që është kredibil.Anëtari i tretë përcaktohet nga Ministria e Arsimit.

**Urim Suka** - unë këtë projekt-vendim dua ta shoh në tri çështje.E para është ajo që tha drejtori,që është obligim ligjor që udhëzimi administrative për zgjedhjen e drejtorave dhe zëvendës drejtorave e jep komisioni në fund miratimin dhe vendimin ta merr Asambleja.Për mu është e panevojshme dhe çuditim pse e kanë fut këtë pike në udhëzim administrativ që kjo çështje me ardhë në Asamble për faktin që një situatë e tillë mundet me krijë vonesa në zgjedhjen e drejtorave apo zëvendës drejtorave dhe me një situatë ku Asambleja mundet me qenë jofunksionale për shkak të ballafaqimeve politike,ky udhëzim është kogja i pazakontë dhe kush do që ka ndikim mundet me propozu dhe me hek krejt sepse është ligji që e rregullon se kush duhet me qenë në komision dhe te ne kur t'vje është formale në një formë.Në rrafshin e dytë që dua ta diskutoj është vonesa.Çuditim si DKA i ka sjell me kaq vonesë propozimet për m'u zgjedh drejtorat.Qe një kohë të gjatë i kemi shkollat me ushtrues detyre dhe kjo vonesë është e

çuditshme dhe i dëmton shkollat drejtpërdrejtë dhe kjo është përgjegjësi e Drejtorit të DKA-së. Zëvendës drejtori në gjimnaz është pensionu me 20 maj 2025 ndërsa drejtori rreth 5 muaj ka dal në pension. Drejtori në Samadraxhë ka mbi një vit që ka dal në pension ndërsa drejtoresha në Shirokë ka 5 muaj që është pensionu, në Bllacë në tetor drejtoresha që ka qenë ka shku. Gjithë kjo vonesë është e çuditshme. Rrafshi i tretë ku e shoh unë këtë që p ndodh sot në DKA në këtë pushtet më çudit. Kohët e fundit ju i keni fillu disa kuvende zgjedhore nëpër nëndegët e juaja por çuditërisht si po përfundojnë drejtorat e shkollave kryetar të nëndegëve. Në Bukosh drejtori i shkollës është zgjedh kryetar i nëndegës së AAK-së. Në Mushtisht drejtori i shkollës është zgjedh kryetar nëndegë i AAK-së. Në Savrovë drejtori i shkollës është zgjedh kryetar nëndegë i AAK-së. Zëvendës drejtori në gjimnaz është zgjedh kryetar nëndegë në Luzhnicë. A e dini që ligji e thotë që tri vitet e fundit drejtori i shkollës nuk duhet me qenë në funksion politik. Drejtor je duke e shkel ligjin. Uroj dhe i ftoj ata që të zgjedhin. Nëse duan të jenë kryetar të AAK-së le ti lirojnë rrugët sepse ka plot njerëz nëpër shkolla që mund të udhëheqin shkolla apo le ta lënë politikën dhe le të shkojnë drejtor shkollash. Ne s'jemi për me vonu sepse mjaft janë vonu këta dhe vota jonë është për.

**Antigona Zyba** - në shkollën e Sllapuzhanit jemi me ushtrues detyre për drejtor, pse nuk është përfshi edhe aty?

**Remzi Bajselmani** - kemi shpall 3-4 herë konkurse por nuk ka pas kandidat dhe DKA është obligu me përcaktu ushtrues detyre. Para se ti bëj 6 muaj ushtrues detyre, edhe një here do të shpallet konkursi nëse do të ketë kandidatë që i plotëson kriteret për drejtor.

**Antigona Zyba** - a është adekuat ai që është ushtrues detyre?

**Remzi Bajselmani** - për atë merr vendim Kryetari i Komunës. DKA mund ti propozoj por në rastet kur nuk ka kandidat që i plotëson plotësisht kriteret, Kryetari merr vendim për përcaktimin e një ushtruesi detyre deri të zgjidhet drejtori kredibil. Urim, ajo që the, një pjesë është ashtu por ti pak po bën politikë. Ne sot i kemi sjell dy anëtarë për komisionin për përzgjedhjen e drejtorëve të shkollave dhe në momentin që është shpall konkursi, DKA ka procedu me rregullore që këta dy persona të jenë kredibil dhe fjala është për këta. Vendimi që e merr DKA-ja duhet me ardhë në Asamble. Ke shumë të drejtë se ligji është shumë kontraverz sepse pasi ta merr vendimin DKA-ja, me sjell në Asamble dhe emrat e njëjtë me i votu për të cilat ne veq kemi marë vendim.

**Urim Suka** - këtë që sapo e tha ne e pranojmë dhe ne e votojmë por pyetja ime ishte se pse është vonu zgjedhja e tyre kur ata kanë dal në pension dhe pse drejtorat po caktohen kryetar të AAK-së.

**Remzi Bajselmani** - nuk i përzgjedhi unë kryetarët e nëndegëve, mundohem ashtu siq duhet DKA-në me funksionu, shkollat. Shkollat janë duke funksionu ashtu siq duhet.

**Kryesuesi** - e hedh në votim pikën 4.

**25 për, 1 kundër, Miratohet pika 4**

**Pika 5. Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit për ndarjen e bursave për nxënës dhe studentë;**

**Kryesuesi** - e elaboron pikën, kërkon propozimet për anëtarë të komisionit dhe hap debatin.

**Dardan Berisha** - unë mendoj që Drejtori i Arsimit duhet të bëj një ndryshim brenda rregullores. Të formoj një komision dhe me pas edhe një ndryshim që me ju dhënë hapësirë atyre që janë në kushte më të vështira, me marrë bursa komunale pasi që komuna më shumë i shikon ato rastet sociale.

**Astrit Salihu** - edhe unë pajtohem plotësisht me Dardanin pasi njëra nga anëtarët tanë në të kaluarën që kanë qenë në komision, kanë tregu që kjo rregullore ka shumë mangësi. Grupi jon mendoj që duhet me ndërhy te rregullorja.

**Aziz Bytyqi** - është e qëndrueshme që rregullorja ka nevojë me u ndryshu sepse kanë ndryshu rrethanat prej kur është nxjerr rregullorja. Ajo rregullore që është bë kur ka ardhë në 2019 e që unë kam qenë kryetar i komisionit, nuk ka kalu si ka ardhë por është ndryshu në Asamble. Çështja e ndryshimit të rregullores aktualisht nuk është e mundshme sepse kriteret për konkurim janë bërë publike dhe në të ardhmen është në detyrën e drejtorit të DKA-së dhe Kryetarit me formu komisionin.

Propozojmë Syl Zenelaj për këtë komision.

**Astrit Salihu** - LDK propozon Doruntinë Zenelaj.

**Dardan Berisha** - PDK propozon Merita Bashën.

**Laureta Tafaj** - LVV propozon Antigona Zybën.

**Jehona Rrafshi Lumi** - duke pas parasysh rregulloren e cila ka shumë mangësi për shkak që kam punu mandatin e kalaur në komisionin e bursave,kërkoj nga DKA që shpalljen tjetër kjo rregullore të rregullohet për shkak të vështirësive të cilat ndodhen në ndarjen e bursave.Unë nuk propozoj të jem pjesë e kërrij komisioni për shkak të rregullores jo adekuate.

**Kryesuesi** - e hedh në votim propozimin për Syl Zenelaj.

**19 për,7 apstenime.**

**Kryesuesi** - e hedh në votim propozimin për Doruntinë Zenelaj.

**7 për,3 kundër,12 apstenime.**

**Kryesuesi** - e hedh në votim propozimin për Merita Bashën.

**18 për,5 apstenime**

**Kryesuesi** - e hedh në votim propozimin për Antigona Zybën.

**17 për,3 apstenime.**

**Kryesuesi konstaton që me shumicë të votave shkojnë: Syl Zenelaj,Merita Basha dhe Antigona Zyba.**

**Kryesuesi** - kërkon emrat nga ekzekutivi.

**Nënkryetarja** - propozojmë Halime Gashi dhe Shega Bajraktari.

**Urim Suka-** janë dy vendime që po duken mire të koordinuara AAK-PDK-VV dhe unë dua të ju uroj zgjerimin e kualicionit.

**Liridon Fandaj** - Urimi është parimor por është parimor vetëm për interesa të subjektit të vet.Në 4 komisione i ke marrë votata në kordinim me AAK-në mandatin e kalaur.

**Urim Suka** - në asnjë rast asnjë koordinim me grupin e AAK-së nuk e kam pas.

**Nënkryetarja** - meqenëse pat problem për shkak të kuotës në mungesë të gjinisë mashkullore,zëvendësojmë Halime Gashin me Jahir Tafën.

**Laureta Tafaj** - i nderuar Urim Suka,në mandatin e kaluar në komisionin për Agin,ti ke dal bashkë me mua jasht dhe je kordinu që Selmani dhe Laureta me shku në atë komision.Kur ke hy brenda një here ti ka lëshu sytë Baliu dhe je tërheq prej komisionit.

**Urim Suka** - është e vërtetë që në vazhdimësi kam bërë përpjekje me u koordinu me grupin e VV-së edhe mandatin e kaluar sepse jemi opozitë dhe kemi mendu që është në interes të qytetarëve si opozitë me qenë të koordinuar.Se kujt ia ka lëshu Baliu sytë e dine krejt qytetarët.

**Laureta Tafaj** - opozita jote ka qenë qysh t'ka konvenu ty.Unë çka du bëj me grupin tim dhe le të jetë e fundit që na kritikon.

**Kryesuesi** - e hedh në votim komisionin me këtë përbërje: Syl Zenelaj,Merita Basha,Antigona Zyba,Jahir Tafaj dhe Shegë Bajraktari.

**18 për,7 kundër,Miratohet Pika 5.**

**Pika 6. Shqyrtimi i projekt-vendimit për emërimin e komisionit për shqyrtimin e shpërblimeve “Emblema e artë”,”Skënderbeu” dhe mirënjohjes “13 Qershori”;**

**Kryesuesi** - elaboron pikën dhe thotë që komisioi do ti ketë 7 anëtarë.Si kryesues i komisionit unë shkoj me automatizën dhe kërkoj propozimet e grupeve parlamentare.

**Aziz Bytyqi** - AAK propozon ilir Vocin.

**Nexhat Ramadani** - ne si grup mendojmë që do të ishte mirë me pas një lloj përfaqësimi dhe kjo nuk po ndodh dhe është një lloj injorance.Me që kështu po shkon,ne nuk kemi propozim.

**Dardan Berisha** - PDK propozon Labinot Halitjahën

**Laureta Tafaj** - LVV propozon Antigona Zybën

**Jehona Rrafshi Lumi** - Nisma nuk ka propozim.

**Kryesuesi** - kryetari i shoqatës OVL UÇK Sejdi Elezi shkon me automatizëm dhe gjithëashtu dhe kryetari i invalidëve të luftës Adem Bytyqi.Kërkoj edhe një propozim.

**Aziz Bytyqi** - propozojmë Mimoza Bajraktarin.

**Kryesuesi** - e hedh në votim komisionin me këtë përbërje: Bexhet Kuçi,Ilir Voci,Mimoza Bajraktari, Labinot Halitjaha,Antigona Zyba,Sejdei Elezi dhe Adem Bytyqi.

**17 për,5 apstenime,Miratohet Pika 6**

**Pika 7. Shqyrtimi i projekt-vendimit për shqyrtimin e vendimit 01-Nr-410-9873;**

**Kryesuesi** - elaboron pikën dhe hap debatin.

**Liridon Fandaj** - në takimin që kemi mbajtë me Kryetarin dhe kryeshefin e Ekoregjionit e kemi diskutu punën e komisionit dhe raportimin. Herën e kaluar nuk kanë raportuar ata që kanë qenë anëtar të komisionit dhe kemi kërku me na raportu. Kryeshefi me vete ka pas raportet që ju ka raportu ty si kryesues dhe Kryetarin në baza tre mujore. E kam fotografu njërin prej atyre dokumenteve dhe asnjëherë nuk na ka ardhë në Asamble një raport dhe me ditë gjendjen financiare të Ekoregjionit. Ai ka thënë që nuk i raportojnë komisionit. A është ky komision funksional apo vetëm dojmë me bo një komision për meditje dhe mos me pas asnjë funksion. Nëse si kryesues të ka raportu, ti si kryesues është dasht me na sjell neve këtë raport në Asamble.

**Kryesuesi** - në takimin që kemi qenë, unë s'kam qenë prezent kurse raportin e ka dërgu te Kryetari dhe unë e kam marrë prej Kryetarit atëhok. Ne jemi duke e shqyrtu pagesën e komisioni dhe çështjen e pagesës ministria na ka obligu që me kry komuna dhe jo ndërmarrja.

**Liridon Fandaj** - e kuptoj kryesues. Ne e kemi edhe stacionin e autobusave dhe stacioni i autobusave ka ardhë çdo here me një raport. Këtu atë ditë u tha që gjendja është alarmante dhe ne asnjëherë nuk kemi pas një raport që me ditë gjendjen. Nëse nuk ka funksion dhe nuk na informon ky komision atëherë është i panevojshëm m'u pagu.

**Avni Bytyqi** - ligji për ndërmarrje publike e specifikon qartë që kudo komuna që është aksionare në një ndërmarrje publike lokale apo regjionale, ka për obligim të themeloj komision prej tre anëtarëve. Ndërsa neni 8 i ligjit për ndërmarrje publike e specifikon qartë ku thotë që komisioni komunal i aksionarëve i raporton kuvendit të komunës për punë, performacën dhe aktivitetet dhe angazhimet e ndërmarrjes publike lokale apo regjionale. Komisioni në bazë të këtij ligji ka për obligim ti raportoj kuvendit. Zyrtari ligjor tutje jep sqarime.

**Flamur Bytyçi** - pajtohem me kolegun që foli paraprakisht i cili vendim ka ndërlidhje me atë që kemi diskutu. Çështja që nuk jam pajtu dhe nuk pajtohem me këtë vendim është raportimi. Nëse dikush është pagu dhe s'ka raportu, nuk është korrekte. Konsideroj që ky vendim mos me kalu, jo për formën e pagesës por për formën e funksionimit. Çka për deri sa publikisht kryeshefi i ndërmarrjes e tha edhe kolegu që nuk e raporton.

**Dardan Berisha** - 2017-2021 kam qenë unë anëtar i komisionit, kemi raportu nëse dikujt i kujtohet por nuk jemi pagu asnjëherë dhe, edhe këto vite 4 vite 2021-2025 nuk janë pagu. Pyetje për zyrtarin ligjor. Ne stacionin e autobusave e kemi 100% nën kompetencën e komunës, pse duhet m'u ndryshu ky vendim që pagesa m'u bë prej mjeteve vetanake dhe kur ka ndryshu ky ligj? Po t'kish qenë që komisionet m'u pagu prej ndërmarrjes, a kemi pas mundësi me ndërhy në pagesën e anëtarëve të komisionit? A ka komuna që i kanë ndërpre krejt pagesat?

**Avni Bytyqi** - ligji për pagat ka hy në 2023-tën në fuqi dhe ju vet jeni dëshmitar që disa prej jush i keni pas nga dy pozita edhe mandatin e kaluar mirëpo nuk ka reflektu as qeveria, as në ministria deri sa ka përfundu mandati. Ne në të kaluarën kompenzimin e këtyre komisioneve e kemi bë nga buxheti i ndërmarrjeve publike për të cilat, në hyrje në fuqi të ligjit për pagat nuk ka reflektu asnjë ministri dhe e ka leju deri të përfundon mandati. Në momentin që ka përfundu mandati për të gjithë, tash e tutje nuk ju ka leju as juve ti mbani dy pozita dhe ti merrni nga dy paga nga buxheti i RKS-së. Ligji për pagat nuk e lejon asnjë kompenzim, asnjë shpërblim, asnjë page, asnjë shtesë tjetër nëse nuk e parasheh ligji i pagave.

**Liridon Fandaj** - ligji i pagave i parasheh dy komisione që janë funksionale por nëse komisionet në kuvend të Kosovës paguhen, edhe ato nuk i parasheh ligji. Të gjitha komunat e kanë me pagesë komisionin. Nëse ti e ke në referencë prej vendosjes të ligjit të pagave që këto komisione nuk janë pagu në ndonjërin komunë, atëherë ne mund të marrim model dhe me vendos por nëse funksionon në gjithë republikën e Kosovës, atëherë duhet me funksionu edhe ne.

**Avni Bytyqi** - Dy komitete janë obligative dhe i parasheh ligji i pagave ndërsa për komisionet tjera për deri sa nuk e rregullon ligji i pagave çështjen e kompenzimeve, nuk mund ti paguash nga buxheti i RKS-së por mund ti paguash vetëm nga të hyrat vetanake të komunës.

**Nexhat Ramadani** - unë dua të diskutoj për atë që për mua është më shqetësuese ndërsa për dikë tjetër është më shqetësuese edhe kur janë themelu komisionet kanë qenë vetëm financat sepse nuk është interesi me pas një komision i cili është i interesuar qysh funksionojnë këto ndërmarrje dhe me i raportu këtij kuvendi por interesi është me pas emrin aty dhe me marrë kompenzimin. Unë mendoj që ka njerëz dhe jemi të gatshëm edhe pa pagesë me qenë në komisione vetëm me qëllim me dhënë kontributin që këto ndërmarrje të funksionojnë më mire. Unë nuk besoj që e ndalon ligji nëse ti e paguan prej të hyrave

vetanake sepse janë paratë tua. Ajo që dua të ngris është për dy pikat e rendit të ditës që i kemi tash, për dy komisionet. Është shqetësuese se prap neglizhenca dhe papërgjegjësia që po na ndodhin neve, na kthehen prap vendimet. Ndoshta është gabim teknik por nuk është dasht me ndodh sepse çdo here po na ndodh me kthy. Unë e shoh që arsyetimin që e ka kthy ministria ka bënë një gabim teknik që nuk e di a e keni vërejt, ku në fund thotë: bazuar në ligjin 08/24 për shqyrtimin administrativ komuna e Prizrenit detyrohet të rishikoj këtë vendim. Ju lus që mos ta shfrytëzojmë arrogancën e votave, të shohim aty ku është e nevojshme potencialin që kemi përmes grupeve, brenda grupeve parlamentare, të propozojmë njerëz që mund të japin kontribut dhe mos të shohim vetëm financat. Ne atëherë kemi votu kundër për shkak të kësaj, dhe kësaj radhe do ta votojmë kundër.

**Avni Bytyqi** - te neni 8 ligji e thotë: çdo komision komunal i aksionarëve i përgjigjet kuvendit komunal në mënyrë se si i ushtron kompetencat dhe përgjegjësitë e veta në raport me ndërmarrjen.

**Jehona Rrafshi Lumi** - flas në cilësinë si anëtare e komisionit të Ekoregjionit. Interesi jonë nuk është vetëm me i marrë meditet. Kemi mbajtur dy takime si grup i komisionit, ku një e kemi mbajtur bashkarisht për detyrat dhe kompetencat tona të cilat kemi me i marrë në bazë të këtij vendimi që është marrë dhe kemi bënë një takim me përfaqësues të ekoregjionit dhe jemi dakordur që ata me na raportu dhe mbetet ta shohim se a do të funksionojë kjo çështje.

**Kryesuesi** - zyrtari ligjor e potencoi që obligohemi të kemi komision për ndërmarrje publike. E hedh në votim pikën 7.

**16 për, 8 kundër, 4 apstenime, Miratohet pika 7**

#### **Pika 8. Shqyrtimi i projekt-vendimit për shqyrtimin e vendimit 01-Nr-410-9874;**

**Kryesuesi** - elaboron pikën dhe hap debatin. Pasi nuk ka debat, e hedh në votim.

**15 për, 8 kundër, 4 apstenime, Miratohet pika 8**

#### **Pika 9. Shqyrtimi i projekt-vendimit për shfuqizimin e vendimit 01-Nr-016-9866;**

**Kryesuesi** - e elaboron pikën dhe hap debatin.

**Laureta Tafaj** - edhe në KPF e kam potencu dhe po e them edhe këtu që në këtë rast Kryetari është treguar frikacak i cili nuk ka qenë në gjendje të përballet me ato kontrata të cilat në vendim thuhet që Kryetari duhet ti ndërpres dhe atë e ka gjujt te Asamblea që me shty edhe për një vit. Ministria e ka kthy dhe tash le t'ju jep sqarim bizneseve dhe qytetarëve për këtë që e ka bërë.

**Sanie Kuçi Rexhepaj** - si grup parlamentar apsolutisht që e përkrahim këtë projekt-vendim, përveç faktit se në seancën e shkurtit kur edhe është miratu raportit i komisionit kemi qenë të zëshëm në kundërshtim të atij projekt-vendimi për arsye se ligji e thotë qartë që kuvendit nuk i takon marrja e masave ndaj kontratave që janë në dhënie në shfrytëzim të pronës komunale por marrja e masave bëhet nga Kryetari i komunës. Si grup e kemi vlerësuar punën e komisionit, raportin i cili është sjell dhe ka qenë hera e pare që është raportu në kuvend në lidhje me zbatimin e kontratave në Zonën Industriale por raportimi sëbashku me projekt-vendim për marrjen e masave për me ju dhënë një vit kohë bizneseve për përmbushje të kontratave, për neve ka qenë e papranueshme për shkak se ka ra në kundërshtim me ligjin. Këtë e tha edhe vet ministria dhe tash po e ridiskutojmë të njëjtën çështje. Vetëm në këtë mbledhje jemi duke i diskutu katër pika që kanë ardhë si pasojë e vendimeve të ministrisë. Kjo rutinë është vazhdimësi edhe e mandatit të kaluar. Për këtë shqetësim mendoj që i pari duhet me reagu ti kryesues dhe je përgjegjës për përpilimin e rendit të ditës. Edhe ne si asambleist kur po reagojmë që me ligje dhe me nene ky vendim është në kundërshtim me ligjin, por edhe vet zyrtari ligjor po thotë që nuk ka bazë ligjore me marrë këtë vendim, ju prap po vazhdoni njëjtë dhe po e bini kuvendin në lajthitje. Zona nuk ka nevojë për vendime formale por ka nevojë për rend, për zbatim të kontratave dhe për trajtim të barabartë për të gjitha bizneset. Unë e kam potencu edhe në shkurt dhe po e potencoj edhe këtë asamble propozimin tim për me hartu një plan të veprimit të qartë dhe të zbatueshëm i cili ka me përfshi kategorizimin e kontratave në bazë të rasteve dhe vendos afate të qarta për zbatim. Raporti i komisionit është një bazë e mire për me hartu këtë plan për shkak se para se me hartu ne një plan, ne duhet me pas një pasqyrë të gjendjes reale dhe në bazë të atij raportit ne e nxjerrim një qëllim, dhe qëllimi besoj që duhet me qenë që me u funksionu ligjërish zona industriale e mbi këtë qëllim pastaj me hartu edhe planin e veprimit. Jam pak skeptike te qëllimi i komunës, ekzekutivi ndaj kësaj zone sepse i kam përcjell

tre mandate në këtë kuvend dhe kam pa raste që ky kuvend përmes fuqisë së votes ka ndodh që nuk i ka dhënë bizneseve që janë serioze parcelë në zone industriale ndonëse që komisioni që ka dal po prej këtij kuvendi e ka rekomandu Kryetarin për me nënshkru kontratën.Ku ka mbet çështja e planit të hollësishëm në zonen industriale në Duhël sepse pëlqimi nga ana e kuvendit ka kalu qysh mandatin e kalaur dhe një plan rregullues nuk duhet m'i marrë 4 vite kohë për me u realizu.Neglizhenca ka shumë.Ne si grup parlamentar e përkrahim këtë vendim për shkak se prej fillimt kemi mendu që është në kundërshtim me ligjin.

**Kryesuesi** - i potencove disa vërejtje në emrin tim por megjithëatë po punohet.Ne si kuvend sjellim vendime,i dërgojmë në ministri,kalojnë,i kthejnë prap,i diskutojmë,i shfuqizojmë prapë,i miratojmë sepse këtë punë e kemi.

**Sanie Kuçi Rexhepaj** - është e vërtetë që duhet me punu por qysh po punohet është edhe ajo çështje që duhet m'u ngrit për shkak se keni neglizhencë.Unë nuk dyshoj që s'kanë m'u marrë masa në Zonë Industriale.Kanë m'u marrë masa për shkak se komuna është nën vëzhgimin e vazhdueshëm të prokurorisë dhe mos marrja e masave në Z.Industriale është keqpërdorim i detyrës zyrtare.Tre mandate mos me u marrë masa është shumë.Me këtë raportim dhe me vendimin që është marrë në shkurt Kryetari ka dasht me mbulu veten.Po mendon që qytetarët dhe bizneset nuk e dine që ai e ka shumicën në kuvend dhe çdo vendim që e ka Kryetari miratohet prej koalicionit AAK-PDK.

**Flamur Bytyçi** - besoj që nganjëherë vjen puna me u bë boll me vendimet që kthehen prej ministrisë dhe ja hup kuptimin edhe kuvendit.Ajo që më shqetëson është që kur e keni themelu ju komisionin, komisioni e ka shkru qartësisht në raport edhe ligjin për dhënie në shfrytëzim edhe në qarkore.Neve si asamble na ka bë të qartë ku duhet m'u thirr dhe cilat janë kompetencat që duhet me marrë veprime për shkëputjen e kontratave.Ne si kuvend kemi bë shkelje të rëndë por unë këtu po e shoh një defekt tjetër që ne duhet me parapa ligjin për me marrë masa edhe ndaj asamblesë,ndaj neve.Në raportin që na është dërgu herën e kaluar,ju e keni emëru një komision për të cilin ju takon me emëru si ekzekutiv,keni kontrata të shkëputura,keni ndërrim të destinimit në atë zonë,zonën e keni lënë 9 vite pa komision dhe tash në këtë moment s'ka komision.Keni borje të papaguara të bizneseve dhe asnjë masë nuk e keni marrë.Ju s'keni pru plan të veprimit që tha Sania.Hajde bjerne një plan të veprimit dhe po e bëjmë bashkë por s'po doni.Bjerne vendimin për shkëputje të kontratave sepse ju kam thënë që publikisht ju përkrahi.Nuk kemi nevojë ne me lane hala dikënd me shfrytëzu e me përfitu,e me marrë qira 15 apo 20 mijë euro e dikush tjetër me prit ose me pagu qera mijëra euro.Kisha dasht secili prej jush me dal me fol dhe me mbajtë pak përgjegjësi për këtë çështje.Kur e ka dorëzu komisioni raportin,Kryetari e ka marrë një vendim tjetër ku thotë: autorizohet,obligohet komisioni me vendim të Kryetarit të komunës për mbikqyrjen e zonës bujqësore në Shirokë,në fshatin Samadrexhë që sipas raporti të dates 04/04/2025 të gjithë operatorët ekonomikë që veprojnë në Z.Industriale në Shirokë të cilët nuk e kanë përmbushur kontratën,të merren masa përkatëse ndaj investitorëve,me vërejtje me shkrim me qëllim të përmbushjes së kontratës.Në momentin që kryetari e ka marrë këtë vendim cila është përgjigja që komisioni e ka kthi?Ne nuk e kemi këtë përgjigje por unë e kam siguru,ma ka dërgu Armendi të cilin e kam falenderu.Komisioni ia ka kthi një përgjigje Kryetarit dhe i ka thënë që ne nuk jemi kompetentë me merr masa në bazë të ligjit për dhënie në shfrytëzim.Çka doni me i thënë bizneseve? Pse nuk po e formoni komisionin për zone?Pse s'keni dal me i mbledh borjet?Pse s'keni dal me i legalizu objektet?Ju asnjë masë nuk e keni marrë.

**Kryesuesi** - e hedh në votim pikën 9.

**24 për,Miratohet pika 9**

#### **Pika 10. Shqyrtimi i projekt-vendimit për bartjen e mjeteve vetanake;**

**Kryesuesi** - e elaboron pikën dhe hap debatin.

**Liridon Fandaj** - sot na kërkohet ta miratojmë bartjen e 746,566.82€ nga viti 2024 dhe 2025.Ky vendim para nesh nuk është sukses por është qertifikatë e dështimit të kësaj qeverisje për dy vitet e kaluar.Ja pse kjo bartje duhet të kundërshtohet:1.qeverisje me përmbarues,jo me planifikim.Nga arsyetimi i këtij vendimi shohim se një pjesë e madhe e këtyre mjeteve,si ato të shëndetit primar në QKMF në vlerë prej 49,384.65€ po barten vetëm për të mbuluar vendime pëmbarrimore dhe gjyqësore.Kjo tregon se komuna nuk i paguan obligimet me kohë duke i shkaktuar buxhetit kosto shtesë të interesave dhe procedurave gjyqësore.2.Bllokim i projekteve kapitale.Është e papranueshme që projektet jetike si ndriçimi publik në Savrovë,Doberdelan,Bukosh,Sopijë të mbeten peng e bartjeve duke thënë që këto mjete nuk janë të

zotuar por nuk kemi pagesa tash. Është një vlerë prej 242,000.00€ në pritje për ekzekutim gjyqësor për ndriçim. Pse nuk janë paguar operatorët ekonomikë me kohë? Pse qytetarët duhet të presin vitin 2026 për projektet që janë kontraktuar në vitin 2024? 3. Është një mjegull e projekteve me bashkëfinancim. Po kërkohet bartja e 316,000.00€ për projekte me bashkëfinancim në bujqësi ku thuhet se 266,235.00€ janë shpenzuar tash më nga vendimet gjyqësore. Ky është një skandal, mjetet e dedikuara për zhvillim rural avullohen nëpër gjykata dhe nëpër përmbaues sipas neglizhencës tuaj administrative. Struktura e shpenzime në vlerë prej 53,826.00 dhe 18,981.00 kryesisht për të larë borgje dhe dështimet tuaja e jo për të arritur cilësinë e shërbimeve qytetare. Kjo bartje prej 746.000,00€ vërteton se ekzekutivi po hyn në vitin 2026 me një çantë plot borgje dhe projekte të dështuara në vitet paraprake. Ju po kërkoni bartjen e mjeteve jo për projektet e reja zhvillimore por të sanuar dëmet e shkaktuara nga neglizhenca e juaj administrative që i ka lënë lëndët të përfundojnë të përmbaues dhe të gjykatat. Kjo mënyrë e menaxhimit parashikon se çfarë na pret në vazhdim të këtij viti. Stagnim, borgje dhe zero investime reale për qytetarët e Suharekës. Nuk mund ta votojmë një bartje që vjen si pasojë e dështimit menaxhues të kësaj qeverisje.

**Flamur Bytyçi** - jam i habitur me shpenzimin dhe mënyrën se si menaxhohet paraja publike në komunën tonë. Është shumë e habitshme që ju nuk keni m'rri me i shpenzu këto dhe është e habitshme se si e keni bërë ndarjen nëpër këto projekte për deri sa ne kemi pas shumë ankesa, ku e kam çek edhe herën e kaluar që nuk keni m'rri me i pagu infermierët që janë me karitas e të njejtën anë ju rrin mjetet pa shfrytëzuar. Është e papranueshme kjo bartje për mua dhe për atë arsye nuk e përkrani.

**Nexhat Ramadani** - sinqerisht për një vendim të till do të duhej me qenë pro, por shqetësimet e Liridonit, të Flamurit edhe tonat janë si pasojë e papërgjegjësisë. Ndoshta Drejtoresha e Financave ose dikush me na dhënë sqarime se sa janë ato që janë bart prej vitit 2024, sa janë prej 2025-tës dhe shqetësimi kryesor i joni është destinimi i këtyre mjeteve. Unë kam informacion që këtu kemi të bëjmë me tejkalim të buxhetit të cilat kanë ardhë si rezultat i denimeve të trafikut e të cilat qe disa vite nuk po planifikohen prej komunës. Vlera e bartjes është pak e madhe që tregon që nuk keni menaxhu si duhet, përpos që nëntor-dhjetor e dime që disa mjete nuk mund të shfrytëzohen. Një prej projekteve që është diskutabile është çështja e projektit të instalimit, sanimeve dhe ndriçimeve publike. Drejtoreshë a janë aloku këto mjete dhe a janë marrë prej përmbauesit apo është në proces?

**Kryesuesi** - në bazë të informacionit prej ZKF janë dy raste që po i marrin mjetet. Rasti i parë ka qenë 240,000.00€ dhe rasti i dytë është mbi 200,000.00€ në vitin 2026.

**Nexhat Ramadani** - nëse një projekt e keni pas të alokuar dhe i kanë marrë mjetet, ne nuk jemi të intresuar me lënë pa buxhet atë. Për shkak të arsyeve tona me keqardhje, ne një vendim i cili po të ishte pak më ndryshe do duhej votuar. Ne nuk e votojmë si grup parlamentar.

**Nënkryetarja** - Vendimi i fundit i përmbauesit që na erdhi ishte mbi 220,000.00€. Ka qenë vendim i kontratave kolektive që kanë bërë padi mësimdhënësit. Pjesa e subvencioneve që është te Drejtoria e Kulturës. E kemi mendu me Kryetarin që ka me u nda për pjesën e startup bizneseve për grate që kemi diskutu me grupin e grave asambleiste. Ne kemi interes me shty këtë pjesë përpara dhe me i përkrani startup bizneset e grave dhe normalisht këto do të bëhen me këtë bartje. Ne ende nuk kemi sqarime dhe sa lëndë të tjera janë në përmbaues që mund të na vijë. Janë duke u bërë padi të reja edhe për 0.5% që është e pamundur me i parapa dhe me i ditë komuna. Sa i përket projekteve me bashkëfinancim, i kam memorandumet e bashkëpunimit me jetimat e Ballkanit për ndërtimin e 20 shtëpive, me Demos me grantin e performacës për ndërtimin e objekteve të Eko Therandës në Shirokë, me ministrinë për rrugën Duhël-Bllacë- anekse. Në këto memorandume bashkëpunimi komuna detyrohet të jap pjesën e vet. Andaj një pjesë e këtyre bartjeve kërkohet të shkohet në këto projekte.

**Urim Suka** - lidhur me projekt-vendimin për bartjen nënkryetarja tha që para 4 apo 5 ditëve na erdh vendimi që janë marrë mjetet. Ky vendim që ne po flasim na ka ardhë para 20 dite. Është një lloj paragjykimi. Ku e keni ditë ju që ka m'i marrë, ku tash i ka marrë pasi e keni lëshu vendimin për bartje, por ndoshta edhe e keni ditë. Nënkryetarja i tha projektet që janë me bashkëfinancim por te kjo bartje kodi është për bujqësi dhe asnjë projekt që e përmendi Nënkryetarja s'ka lidhje me bujqësi. Ky është shqetësimi jonë, te shpërndarja. Vlera e bartjes është 746,000.00€. Në një vit ku ju jeni anku që përmbauesi ju ka marrë miliona euro, juve ju kanë mbet këto para, edhe të 2024-tës nuk i keni shpenzu por edhe 2025-tës nuk i keni shpenzu. Instalimi dhe sanimi i ndriçimeve publike në fshatra janë 236,000.00€. Në buxhetin që është miratu janë të planifikuar 280,000.00€ për të njejtin projekt. Tash pe kalojnë 500,000.00€. Kanë mujt me i marrë përmbauesit por përmbauesit mund ti marrin edhe te projektet tjera dhe jo vetëm këtu. Problemet nëpër fshatra me kanalizime janë aq të mëdhaja sa që është

një lloj lluksi m'i qu te ndriçimi. Shpërndarja na duket që s'është e drejtë. Për të gjitha këto, ne mendojmë që nuk mund ti japim mbështetje edhe mbi bazën e informatave që na dhatë.

**Labinot Halitjaha** - nuk është e vërtetë që janë bartje 746,000.00€. Në muajin janar na ka ardhë shpenzimi i buxhetit për periudhën janar-dhjetor për vitin 2025. Nëse Urim ke qenë atëherë dhe e kemi diskutu dhe je qe sa here në asamble, e din mirë që nëntor-dhjetor të hyrat vetanake nuk shpenzohen ku janë në vlerë 592,354.00€. Vlera e bartjes është 146,000.00€ të cilat nuk mund të shpenzohen. Duhet me qenë të qartë dhe jo me bë dezinformata këtu sepse sa herë është diskutu, ti e thua këtë vlerë. Qytetarët duhet ta kuptojnë këtë, dhe sa del e flet duhet me qenë më i sinqertë dhe jo me bo gjithmonë politikë. Nëse e ke pa periudhën janar-dhjetor 2025 shfrytëzimi i buxhetit është mbi 96% në total.

**Urim Suka** - dua të më mirë kuptoj drejtori. Për here të pare e kuptova saktë fjalë për fjalë sepse kur ka qenë më herët drejtor e ka pas më zor sepse u deshke m'i mbulu. Edhe ky tash e devijoi për me bo politikë sepse tha: ku pe sheh atë 746,000.00€? Unë po e shoh në vendimin që ju e keni pru. Ka të drejtë që tre muajt e fundit nuk mund ti shpenzojmë por unë po e bëj kritikën që ju e keni bërë për neve më herët, ku nga 300,000.00 i kemi pas e 600,000.00. Për 98 % të buxhetit që është shpenzu, ju vet keni thënë që përmbaruesi i ka marrë një pjesë të madhe të atyre.

**Labinot Halitjaha** - në kohën që po flet ti, 600,000.00€ ndoshta kanë bë 30% ose 40% të buxhetit ndërsa në kohën që po flasim, 146,000.00€ nuk bëjnë as 1% të buxhetit.

**Flamur Bytyqi** - kjo vlerë është për vitin 2024-2025 por ti e përmende që është vetëm për muajin e fundit që s'ka mundësi me u shfrytëzu.

**Erëza Ramadani** - Urimin dua ta sqaroj që mjetet e bashkëfinancimit janë të parapara si kod ekonomik në Drejtorinë e Bujqësisë. Nexhatit dua ti them që nuk mund ne ta bëjmë planifikimin e të hyrave prej gjykatës dhe prej trafikut sepse ato i bën Ministria e Brendshme dhe për këtë edhe kanë dale të pasakta sikurse e tha edhe Nexhati.

**Kryesuesi** - e hedh në votim pikën 10.

**4 për, 12 kundër, 1 apstenim, Miratohet pika 10.**

**Pika 11. Informatë për administrimin e buxhetit të Komunës së Suharekës për periudhën janar-mars 2026;**

**Kryesuesi** - e elaboron pikën dhe hap debatin.

**Qëndrim Elshani** - pas analizimit financiar për tre mujorin e parë të viti 2026, si asambleist i këtij kuvendi dëshiroj të adresoj disa shqetësime serioze lidhur me performancën e ekzekutivit komunal.

1. Dështimi në realizimin e të hyrave vetanake: -Rënie drestike ku realizimi të hyrave vetanake është alarant, me një rënie prej 23.09% krahasuar me të njëjtën periudhë të viti të kaluar. -Tatimi në prone: mbledhja e tatimit në prone është realizuar vetëm në kuotën 20.59% të planit, që paraqet një rënie prej 57.45% krahasuar me vitin paraprak. Kjo tregon një paaftësi të ekzekutivit për të menaxhuar arkëtimet e mjeteve që janë jetike për projektet tona lokale. -Mosarritja e planit: në total kemi arkëtuar rreth 263,104.00€ më pak se sa ishte planifikuar për këtë tremujor. 2. Paralizimi i investimeve kapitale. - Realizimi zero: është e papranueshme që nga granti qeveritar dhe nga fondi burimor vetanak, që shpenzimet për projektet kapitale janë 0.00%. -Mungesë dinamike: ndonëse raporti arsyetohet me vonesat e aprovimit të buxhetit, fakti që vetëm 1.86% e totalit të projekteve kapitale janë shpenzuar, tregon se qyteti dhe fshatrat tona kanë mbetur pa asnjë investim real gjatë këtij tremujori.

3. Strukturë e pabalancuar e shpenzimeve. -Mbipesha e pagave: nga buxheti total i shoenzimeve prej 4,909,833.86€, rreth 88.59% shkon vetëm për paga dhe shtesa. -Mungesa e zhvillimit: ndërsa për paga shpenzohet pjesa dërmuese, për subvencione dhe transfere janë shpenzuar vetëm 0.92%, duke lënë anash mbështetjen për bujqit, sportin dhe rininë në këtë fillim viti. 4. Menaxhimi itepriçës buxhetore.

-Mjete të fjetura: raporti tregon një tepriçë prej 7.7 milion euro të cilat barten në periudhat e ardhshme. Kjo nuk është shenjë ekursimit por shenjë e mosplanifikimit dhe mosekzekutimit të projekteve që do të duhej të ishin në fazën e tenderimit apo punimeve.

**Urim Suka** - kur po flasim për tremujorin duhet ta kuptojmë një fakt se buxheti është votu me vonesë dhe kjo ka kriju vonesa edhe për juve për me shpenzu buxhetin në mënyrën si keni mujt me planifiku në një situatë normale, edhe tremujorin e kaluar të njëjtën situatë e kemi pas. Unë besoj që komuna duhet me pas edhe kontrata dyvjeqare dhe këtu më shqetëson ajo pjesa sepse të paktën këto dy kontrata dyvjeqare kur edhe koha ka qenë e mirë, pse nuk është punu pak ma shumë sepse te investimet kapitale me sa unë po shoh, del që gati është zero shpenzimi. Është mire me pas parasysh që shpenzimi i parasë

m'u shpërnda nëpër muaj sa më mirë.Çka po ndodh me qeverinë tuaj?që prej se unë jam në asamble është që 80% e buxhetit shpenzohet tre muajt e fundit.Kur ti e koncentron 80% të buxhetit 3 muajt e fundit,as nuk ka cilësi,as nuk ka shpenzim si duhet,as nuk ka mbikqyrje e as kurgja.Ju lus që në raportin 6 mujor me pas projekte që kryhen sa ma shpejt që mos me lënë buxhetin në fund sepse kjo po krijon vështirësi të madhe.

**Erëza Ramadani** - është shqetësuese vërtet fakti i të hyrave vetanake,por nuk ka qenë përgjegjësi e jona.Nuk ka pas sistem të faturave të tatimit në pronë deri më 31 mars sepse nuk i ka lëshu qeveria.Edhe faturat e taksave në aktivitet janë vonë shumë këtë vit dhe për këtë arsye ka pas shumë ulje në pjesën e tatimit të pronës.

**Qëndrim Elshani** - është mirë me pas në infomatë herave tjera.

**Erëza Ramadani** - ato i ka përgadit ZKF dhe shpresoj herave tjera nëse ka diçka do ju informojmë.Te investimet kapitale buxheti është aprovu me vonesë dhe për shkak të procedurave nuk kanë mundur të bëhen menjëherë dhe për këtë arsye shpenzimi është shumë i vogël.

**Kryesuesi** - buxheti është aprovuar në janar të viti 2026 dhe për fat jo të mire edhe qeveria e RKS-së nuk e ka pas të miratuar buxhetin në nivel të RKS-së dhe ju e dini që disa komuna dhe qevria e kanë shfrytëzuar 1/12 e buxhetit.

**Flamur Bytyçi** - te çështja e tatimit në pronë që në raport është 57.45% më pak krahasuar me vitin e kaluar,një këshill ose vërejtje është çështja që në momentin që kanë dal faturat,nuk kam pa ndonjë njoftim për publikun për këtë çështje për të cilën mendoj që duhet me bo si ekzekutiv përderisa komunat tjera e kanë bo.Nëse doni me pas sukses,në momentin që del fatura e tatimit në prone duhet me njoftu qytetarin.Te të hyrat vetanake,jo e tatimit në pronë,edhe këtu jeni më pak krahasuar me vitin e kaluar,23.09%.Çka ka ndodh këtu,pse nuk keni më shumë të hyra?

**Erëza Ramadani** - e thash dhe më herët që janë vonu faturat e taksës në aktivitet.Janë shpërnda me vonesë dhe për shkak të marrëveshjes që i ka skadu me operatorin që e bën shpërndarjen e faturave dhe sistemi i tatimit në pronë nuk ka qenë duke funksionu.Edhe tash që janë lëshu faturat,ne prap kemi problem me faturat e tatimit në prone edhe përkundër që kemi kërku sqarim nga ministria se çka po ndodh me sistemin që ato fatura po gjenerohen gabim.Ministria nuk na kanë përgjigje.

**Flamur Bytyçi** - si e bëni shpërndarjen e faturave jo për tatim në pronë por për biznese,renta ose për zone industriale? Pse ka ardhë deri te vonesa që e keni bërë marrëveshjen e re ose kur është bërë marrëveshja e re,kur i ka skadu kontrata marrëveshjes?

**Kryesuesi** - si e tha edhe drejtoresha sistemi i tatimit në prone nuk ka funksionu në nivel të Kosovës.Tatimi në prone si e hyrë vetanake që është,është edhe pjesa e rentës dhe unë jam i bundur që lidhet me atë program.

**Labinot Halitjaha** - së pari Drejtoresha e Financave është e re dhe stafi kanë prit deri sa të vjen dikush tjetër me pa se si funksionojnë politikat e një drejtori tjetër.Për tatimin në pronë problem është i programit nga ministria.Për taksat në aktivitet dhe taksat tjera,normal drejtoresha ka ardhë risht dhe e kanë prit momentin deri sa të vijnë sepse ne i shtypim në drejtori dhe ia japim postës së telekomit dhe i shpërndan të gjitha faturat.Kjo ka ndodh brenda një muaj e gjysmë.Është pjesa e pare e vitit dhe buxheti llogaritet gjithmonë në përfundim se sa u shpenzu dhe sa ka pas të hyra.

**Flamur Bytyçi** - nëse ke marrëveshje me postën,pse nuk i ke dërgu vërejtje ose si është marrëveshja që ju e keni nënshkru?

**Erëza Muqa** - në momentin që është lidh kontrata me postën,posta veq e ka bërë shpërndarjen e faturave të taksës në aktivitet.Problemi ka qenë vetëm te vonesa e faturave të tatimit në prone për shkak që ministria nuk po ua dërgon postës që me mujt ata me bo shpërndarjen në mënyrë të duhur.I kemi kontakti,s'kanë dhënë përgjigje.Çdo gjë në kompetencë tonën jemi duke e bërë.Çdo qytetari të interesuar jemi duke ia dhënë faturën dhe janë duke vazhdu me pagesa.

## **Pika 12. Pyetje dhe përgjigje;**

**Jehona Rrafshi Lumi** - Drejtoreshë sigurisht jeni e informuar që mamografia në komunën tone është jasht funksionit.Duke e pas parasysh që kjo është një element bazë për shërbimin e grave të komunës së Suharekës,unë para disa dite,disa paciente i kam dërgu në Malishevë për fotografim të mamografisë dhe të lus të shkosh dhe të shikosh se çfarë shërbimi cilësor bëhet atje dhe çfarë operatore ka.Gjatë vizitës në QMF-në në Duhël,atje ka mungesë të fashave dhe gazave sterile dhe pacientët janë detyru me i ble vet.Është ngritur shqetësim nga kolegu Urim për shkak të ujit të pijshëm ku në Duhël nuk ka ujë

të pijshëm.Si mund të kryhet një shërbim pa higjienë,pa ujë dhe pa gjendje elementare?Sot kërkoj që të mirret veprim urgjent për këto çështje dhe zgjidhje konkrete dhe pse nuk është vepruar me kohë? Kam një shqetësim lidhur me një vendim të muajit mars për ndërprejen e mbushjeve telefonike për udhëheqësit e sektorëve pa konsultim dhe pa rishikim të nevojave reale të punës.Ju e dini që shumë zyrtarë kanë nevojë dhe kanë palë që kanë bisedime brenda dhe jasht vendit dhe drejtorave nga 50€ në 820€ u janë rritur bonat për mbushje.Mbi çfarë baze dhe nga kush është marrë ky vendim dhe pse nuk është bërë një vlerësim drejt nevojave të punës?

**Kymete Bajraktari** - për çështjen e mamografisë e di që është një në ditë por do të interesohem. Sa i përket çështjes së gazrave,është problem në gjithë Kosovën por për fasha nuk e di që ka problem.Sa i përket ujit në Duhël,është një projekt me bashkëfinancim ku deri në korrik shpresoj të kryhet.

**Nënkryetarja** - vendimi për ndaljet e mbushjeve të telefonit janë vendime të Kryetarit të cilat Kryetari ka vendos me i shfuqizu të gjitha mbushjet e telefonit dhe pijeve për zyrtar në muajin mars.Drejtorëve ju ka rrit pjesa e byfesë dhe ju ka zvogëlu pjesa e telefonit.Pra nuk kalon pjesën e buxhetit.Kryetari mund të mer vendime tjera për mbushje të telefonit në bazë pozitive dhe nevoja që ai i sheh të arsyeshme.

**Dardan Berisha** - unë mendoj që duhet m'u rrit bashkëpunimi i DKA me shkollën 7 Marsi.E dime që kjo shkollë ka rrije çdo herë të numrit të nxënësve dhe duke pas parasysh këtë,unë mendoj që duhet të bëhet një kontroll i jashtëzakonshëm i nxënësve aty sepse ka ankesa të jashtëzakonshme prej nxënësve dhe problemeve të shumta që ka shkolla 7 Marsi.Ka problem që rrahen nxënësit çdo ditë .

**Vlorë Kryeziu** - fillimisht dua të falenderoj Drejtorinë e Shëndetësisë për përgjigjen e dhënë lidhur me kërkesat për personat me dëmtim me shikim dhe për bashkëpunimin institucional.Sipas të dhënave zyrtare në komunën tonë janë të regjistruar 63 persona me dëmtime të rënda në shikim dhe po ashtu nga drejtoria jam informuar se është ofru mbështetje për shoqatat e personave të verbër përmes sigurimit të një zyre në katin e dytë dhe përkrahje për aktivitetet strukturore dhe sociale,por për fat të keq kjo nuk është realiteti për të gjithë.Sot unë po e ngre çështjen për personat e shurdhër në komunën tonë.Këtu kam kërkesën e shoqatës së të shurdhërve ku kërkesat e tyre janë bazike. 1.lirimi nga pagesat në sportelet e gjendjes civile;mundësi reale për punësim;informim në gjuhën e shenjave dhe intepretim në këtë kuvend.Unë kërkoj përgjigje të qarta nga drejtoritë përkatëse,afat konkret për zbatimin e këtyre kërkesave dhe angazhim real nga institucionet.Poashtu kam pyetje edhe për Drejtorinë e Urbanizmit.Kërkesa ime ka qenë zyrtare për të cilën nuk kam marrë konfirmim.Kam kërkuar çasje në dokumentin e HZK-së,një dokument kyç për zhvillimin urban dhe përfshirjen sociale.Kur do të kem çasje në këtë dokument dhe poashtu në kuadër të planifikimit urban dhe përfshirjes sociale,kërkoj sqarime shtesë lidhur me: cilat masa janë ndërmarrë tani për vendosjen e rampave për karroca nëpër trotuare dhe në institucione publike? Nëse komuna ka plan konkret për vendosjen apo pozicionimin e shiritave taktil për persona të verbër,posaqërisht që i kemi në shesh dhe çfarë veprime janë ndërmarrë për përmirësimin e vendkalimeve për këmbësorët në shesh.Kërkoj përgjigje mundësisht konkrete dhe trajtim më prioritet të drejtorive përkatëse.

**Kymete Bajraktari** - sa i përket kërkesës së të shurdhërve,edhe ata janë mbështet njejtë sikurse shoqata e të verbërve.Edhe ata kanë zyre,transport prej komunës e shumë aktivitete mbështeten prej komunës.Sa i përket lehtësimit në pagesa për ata,e përcakton ligji dhe ne nuk mund të bëjmë asgjë.Është ligji për personat me aftësi të kufizuar dhe vetëm në ligj përcaktohen kategoritë të cilat lejohen për mospagesë të dokumenteve personale.Sa i përket interpreterit,shoqata e angazhojnë dikënd.

**Kryesuesi** - sa i përket interpreterit e kemi diskutu edhe në të kaluarën dhe do të ishte mire ta kemi. Duhet ta shqyrtojmë mundësinë e pagesës për interpreterin sepse mire do të ishte me qenë në sallë.

**Kymete Bjaraktari** - për momentin ne në komunë nuk mundemi me shtu punëtorë ekstra sepse e kemi të kufizuar numrin e banorëve mirëpo duhet me pa mundësinë me mallra dhe shërbime diçka me bo.

**Vlorë Kryeziu** - po e lexoj paragrafin që ma kanë shkru.Të gjithë anëtarët e shurdhër në Kosovë janë të paisur me kartela identifikimi si persona të shurdhër ku me anë të kësaj karteles lirohen nga pagesat në QKMF dhe në shërbimet komunale tek gjendja civile.Këtu në Suharekë thotë:ne lirohemi vetëm në QKMF ndërsa në komunë nuk lirohemi.Ata kanë informacione se në Malishevë,Rahovec dhe në komuna tjera lirohen edhe në shërbime komunale.

**Kymete Bajraktari** - ne e kemi aprovu një rregullore në asamblenë komunale ku në këtë rregullore ata nuk janë të liruar për shkak se ne i kemi kategoritë të cilat janë të liruara,ata janë veteranët,invalidët etj.

**Visar Kuçi** - sa i përket HZK-së që keni bërë kërkesë për çasje në dokument,këtë dokument tani veq komuna e Suharekës e ka publ.E ke në faqen e komunës,e ke në vegëzën te Drejtoria e Urbanizmit,aty

e ke edhe Hartën Zonale, Planin Zhvillimor komunal dhe planet tjera që i ka kjo drejtori. Drejtori tutje jep sqarime.

**Vlora Kryeziu** - po e kuptoj por pse atëherë nuk më është dërgu qasja përmes kërkesës zyrtare.

**Visar Kuçi** - qasja është. Për veç asaj nëse nuk mund ta kuptosh këtë dokument, në objektin e komunës, para Drejtorisë së Urbanizmit është një ekran dhe gjatë orarit të punës secili qytetar që ka një kërkesë mundet me shiku këtë dokument.

**Vlora Kryeziu** - unë e e kuptova dhe e di që është publike por çështja është se pse nuk ma ke dërgu në mënyrë zyryare këtë përgjigje.

**Visar Kuçi** - sa i përket pjesës së sheshit, është duke u realizu projekti i sheshit dhe ta kam cek edhe asamblenë e kaluar. Komuna vazhdimisht duhet ti plotësoj normat të rampave, të çasjeve, të parkingjeve me hendikep e të gjitha dhe çdo here veq jemi duke i avancu.

**Vlorë Kryeziu** - po për këtë arsye unë kam kërku çasje në këtë dokument. Unë kërkoj prej teje se kur do të kem çasje. Unë po kërkoj bashkëpunim që ti analizojmë çështjet që unë i kam ngrit më herët në asamble. Unë e kam kërku HZK-në, e kam pa dhe e kam analizu. Për këtë arsye unë po kërkoj çasje në mënyrë zyrtare përmes drejtorisë së Urbanizmit. M'u përgjigj në mënyrë zyrtare të lutem ashtu sikurse t'u kam drejtu unë. Çfarë veprimesh janë ndërmarrë për përmirësimin e vendkalimeve për këmbësor?

**Visar Kuçi** - komuna në vazhdimësi planifikon projekte për shenjzimin vertikal dhe horizontal të rrugëve.

**Astrit Salihu** - pyetja ime është për Drejtorin e Arsimit dhe është shqetësim i nxënësve së shkollës së mesme "Avdyl Rama". Kur është dhënë byfeja e shkollës në shfrytëzim apo është bërë kontratë, a janë paraparë edhe çmimet? Nuk e di a kanë të drejtë byfetë t'i rrisin çmimet kur ata dojnë sepse sipas meje nuk është korrekte që çmimet e një byfeje të shkollës të jenë të njëjta me çmimet e lokaleve të cilat janë në shesh të qytetit. Një byfe e cila ka një shërbim cilësor jep edhe një kontribut të madh dhe mundëson që nxënësit e asaj shkolle të mos dalin jasht ambientit të shkollës por fatkeqësisht në këtë rast nxënësit dalin jasht ambientit dhe bëjnë porosi edhe nga lokalet në qytet të cilat shumë shpesh i dërgojnë porositë më lire se byfeja në shkollë.

**Remzi Bajselmani** - unë nuk kam informacion për këtë. Do të interesohem dhe do t'ju përgjigjem.

**Liridon Fandaj** - pse Drejtoreshë që një vit e ca është QKMF-ja pa drejtor në Suharekë dhe deri para dy jave cila ka qenë arsyeja që materiali shpenzues ka mungu në QKMF? Asamblenë e parafundit kemi diskutu për qendrën e autizmit me nënkryetaren, cilat janë hapat që i ke marrë për me zgjidh atë çështje? Pas një reagimi që e kam pas në facebook kam pas shumë telefonata të njerëzve që duan ta ndihmojnë atë qendër të autizmit por pasi ti m'ke thënë që nuk është me dokumenta në rregull, unë nuk ju kam rekomandu me shku aty. Para dy dite e kam pa një ftesë për dëgjim publik për rregulloren për mbeturina, a ka ndryshu ajo rregullore që e kemi miratu ne? Nëse është bërë një rregullore e re, edhe mund të mbajmë dëgjim publik por nëse janë ftu qytetarë dhe ne si asamble nuk kemi pranuar ftesë as prej Kryetarit dhe as prej kryesuesit për atë dëgjim publik. Pyetje drejtorit të Arsimit. Si ka mundësi me u punësu në shkollë një asistent për fëmijë me nevoja të veçanta apo lokopede, nuk e di, ku në momentin që punësohet shkon në pushim të lehonisë? Drejtorit të Urbanizmit ia kam bërë një kërkesë për shfrytëzim të pronës publike, konkretisht për hapësirat në shesh. I ke kalu të gjitha afatet dhe nuk je përgjigj edhe pse e kam dërgu edhe në agjension. A po pret që agjensioni me ndëshku drejtorinë dhe komunën e nuk po don me dhënë informatë apo është neglizhencë e stafit tend ose e jotja? Ka ndodh një fatkeqësi në Shirokë përball qendrës Kastrati ku janë shkel dy qytetarë në atë pjesë. Pjesa e kalimit aty, a ka leje? Nga kush është dhënë ajo leje për atë vendkalim? Ne e kemi një nënkalm dhe ai nuk po shfrytëzohet. Edhe Drejtorisë së Inspektionit i kam bërë kërkesë për lejen e objektit dhe për të gjitha matjet që i ke bërë te Elkosi dhe m'ke thënë që do ta sjellësh sot në Asamble por sot nuk më ka ardhë.

Është shqetësuese sepse në çdo vendpunim të operatorëve ekonomikë prej Flamurit e deri në territorin e komunës tonë, mbi 85% të vendpunishteve nuk kanë të publikuara se a kanë leje ndërtimi apo nuk kanë. Ju në njërën anë po i bëni dëm edhe atij operatori që ka leje ndërtimi për një urdhëresë të inspektionit që duhet ti thotë: ju duhet me publiku lejen e ndërtimit në atë pjesë. Pyetje për Drejtorinë e Shërbimeve Publike. Në rrugën "Kenan Halimi" në drejtim të fshatit Peqan janë zhvilluar disa punime në ujësjellës. Pjesa e trotuarit është gërmu dhe ashtu kanë mbet siq janë kry punimet. E kuptoj që aty është një tender për këtë rrugë nga ministria por për deri sa ai i ka kry punimet, është dasht me kthy në gjendjen e mëparshme trotuarin sepse qytetarët rrezikojnë. Te pjesa e rrethrotullimit në atë rrugë është edhe një rrezik që unë edhe asamblenë e kaluar e kam kërku që me bërë një vendkalim nga ana e majtë në të djathtë dhe në të kundërtën. Edhe te nënkalmi i autostradës ndriçimi nuk funksionon aty e aq më

keq që nxënësat e fshatit Peqan kalojnë aty çdo ditë dhe janë disa kablllo të rrymës që nesër mund të ndodh ndonjë fatkeqësi. Pyetje për Drejtorinë e Bujqësisë. Kur do të del thirrja për fermerët dhe cili është planifikimi juaj për mbështetjen e fermerëve?

**Kymete Bajraktari** - jam interesuar se pse nuk ka drejtor dhe më është thënë që vitin e kaluar para se me qenë unë drejtoreshë ka qenë një konkurs por nuk ka pas të interesuar, dhe është pak problematike për shkak se ligji e parasheh vetëm specialistin e mjekësisë familjare me qenë drejtor i QKMF-së. Jam duke biseduar për me hap procedure por unë e di që interesimi i mjekëve të mjekësisë familjare për me u bë drejtor të QKMF-së është shumë i vogël. Për material shpenzues, unë e di që nuk ka gaza dhe dorëza të cilat janë problem në gjithë Kosovën dhe nuk e di pse. Ndërsa për material tjetër nuk kam informata që ka mungesë.

**Liridon Fandaj** - te pjesa e drejtorit është mire me vendos konkursin dhe tani a konkurron apo jo është pjesë tjetër por nuk besoj që nuk ka pas shumë interesim. Unë informatat i kam që ka pas interesim por s'ka qenë dikush adekuat i juaji dhe nuk ka konkuru.

**Kymete Bajraktari** - konkursi është i hapur dhe të drejtë aplikimi kanë të gjithë.

**Nënkryetarja** - Çështja e fëmijëve me autizëm është një çështje e ndieshme për ty, për mua dhe për të gjithë këtu dhe për të gjithë qytetarët. Sa i përket licences për një shoqatë të caktuar ne nuk kemi kompetenca, licencat i jep ministria. Çka do që ju si asambleist mundeni me ndihmu, ne si komunë çka do që mundemi me ndihmu shoqatën, jam për ta ndihmu por nuk jemi ne institucioni që i japim licencat e punës. Edhe personalisht jam e interesuar sepse është një kategori e ndieshme që ka nevojë. Përveç intervenimeve që do të duhej të bëheshin në ligj për ta ndihmuar këtë kategori, edhe si komunë ashtu sikurse keni marrë vendim me ndihmu Hendikosin besoj që kishit marrë vendim si asamble njëjtë me ndihmu këtë kategori por ne nuk jemi institucioni që e licencojmë. Nuk i kam taku më dhe nuk kam informacion se çka ka ndodh.

**Liridon Fandaj** - objekti është i komunës dhe realisht aty po funksiononi diçka që s'është e ligjshme.

**Nënkryetarja** - unë besoj objektin që e keni dhënë në shfrytëzim, e keni dhënë pa qenë unë këtu.

**Liridon Fandaj** - unë nuk po të them direkt por s'do të thotë që nëse dikush tjetër ka qenë në vendin tënd e s'ka marrë masa, ti si nënkryetare ose si ekzekutiv duhet me marrë masa dhe me zgjidh këtë çështje dhe të paktën ne si Asamble me nxerr një vendim që atë pagesë që po e bëjnë ata fëmijë, me i ndihmu dhe jo me pagu ata diçka dhe në anën tjetër thonë që është duke e shfrytëzuar dikush në mënyrë të paligjshme.

**Nënkryetarja** - e di që objekti është donacion prej një biznesi por si e kemi dhënë nuk jam e informuar. Sa i përket me ndihmu, unë jam për ta ndihmu këtë kategori. Masat e tjera që mund ti marrim, do ti shqyrtojmë. Sa i përket pyetjes për rregulloren për mbeturinat, me që rregullorja është miratu në asamble dhe ka shku në ministri, ministria e ka kthyer rregulloren me tri vërejtje për t'u përmirësuar. Kur e kam nënshkruar kërkesën për me dal në shqyrtim publik, i kam kërku zyrtares me i thënë Avniut dhe me ia dërgu ftesën asambleistave njëjtë sikurse ia dërgon ftesën për asamble me email. A e kanë dërgu, nuk e di.

**Liridon Fandaj** - edhe herën e kaluar ka qenë ky arsytim por nëse vjen kjo rregullore dhe na kërkoni me votu, do të duhej të ishim ne të njoftuar se cilat janë ndryshimet dhe a kemi ne një kontribut me dhënë në atë rregullore që me zgjidh këtë problem por jo kur po vje problemi me zgjidh, hajde të bëhemi bashk e po e zgjidhim.

**Visar Kuçi** - kërkoj falje publike për mosdërgimin e dokumentave. Unë e kam dërgu te zyrtari përgjegjës, është bërë një gabim që e ka ngarku dokumentin dhe me ti dërgu ato hapësira publike. Ne ta dërgojmë përgjigjen ty, edhe kur t'na vjen prej agjensionit ia kthejmë që është dërgu me vonë. Sa i përket pjesës në Shirokë, te zebrat, dikush ka bërë një kërkesë dhe janë me pëlqim. Eksperta kanë dale, e kanë verifikuar zonën se a i ka plotësu kushtet për me bartë vendkalimin për këmbësor dhe janë punu. Zona sa e di është 30 në orë dhe më vjen keq që ka ndodh.

**Liridon Fandaj** - nëse një nënkallim e keni investu dhe nuk janë as 200 m larg atyre është e pakuptimtë me i dhënë pëlqim dikujt e me rreziku qytetarët.

**Visar Kuçi** - i ka plotësu kushtet dhe nëse don ta dërgoj edhe pëlqimin.

**Remzi Bajselmani** - me përgjegjësi të them se nuk është punësu asnjë militantë. Kanë konkuuru 8 persona dhe 8 janë pranuar. Të gjithë ata që kanë konkuru kanë pas përgaditje profesionale dhe të gjithë ata kanë vërtetim nga mjeku që janë të aftë për me punu dhe asnjë deri më sot nuk ka shku në pushim të lehonisë.

**Liridon Fandaj** - të kërkoj falje nëse jam gabim por do të interesohem për këtë pjesë.

**Gent Gashi** - çdo ndërtim ka leje dhe ka pano informuese.Nëse e gjen një që nuk ka pano informuese,bëje foto dhe unë marrë përgjegjësi.

**Liridon Fandaj** - nuk po bëj foto por unë të sfidoj të shkojmë bashkë dhe secilën punishte ta shikojmë.

**Armend Krasniqi** - Drejtoria e Bujqësisë ka të ndarë një buxhet në këto kategori të ndarë: rrugë fushore 100 mijë euro,rruga për Vraniq vazhdim 10 mijë euro,kanalet e ujitjes 30 mijë euro,mallra shërbime 50 mijë euro dhe projekte me bashkëfinacim 370 mijë euro.Ndërsa nga subvencionet kemi pasur borgje paraprake të cilat jemi duke vazhduar ti lajmë tek operatorët të cilët i kemi borxh dhe shumë shpejt pritetë që të bëhet një njoftim për mekanzëm bujqësor dhe sera.

**Liridon Fandaj** - nëse ti e qet një mbështetje për sera,besoj që shumica tash i kanë mbjell ato sera.A do të thotë që ne tash me hap thirrjen e për vitin e ardhshëm me punu ata në ato sera?

**Armend Krasniqi** - sipas ligjeve në fuqi ne duhet ti vizitojmë fermerët dhe duhet të bëjmë dëgjime publike.Në bazë të kërkesave të fermerëve dhe dëgjimeve publike,ne marrim një iniciativë për ta bërë shpërndarjen e atyre se çfarë kanë nevojë fermerët.Dua të ju njoftoj se kemi nënshkruar një kontratë për sjelljen e 60 mushtjerrave të cilat do të vijnë në shtator nga Irlanda.

**Amir Hoxha** - rastin e njejtë sikurse te rruga Kenan Halimi e kemi edhe në qytet te lagjja lartë,te objekti i Isuf Hajdarit dhe hidroregjioni është duke e bërë instalimin e ujit mirëpo si faze fillestare ata e bëjnë gropimin dhe shtrirjen e gypit gjatësor.Pastaj duket se kanë faze tjetër të punimeve,andaj edhe kanë mbet hapyr aty për shkak se kanë m'i vendos pusetat për orëmatës,ndërsa e kanë obligim me kontratë që pas punimeve ta sjellin në gjendjen paraprake.Te ndriçimi i urave në Peqan,sinqerisht me konfiskimin e mjeteve nga përmbaruesi me vendim të gjykatës për ndriçimin publik,unë e kam inicuar një procedure të prokurimit për mbylljen e të gjitha trupave ndriçues në qytet,rreth shkollave dhe ku e kam pa të arsyeshme që paraqesin rrezikshmëri.Sot përfundon kjo procedurë e prokurimit dhe e kam ndërmend me e bo mbylljen e sanimit sepse në gjithë qytetin,në shesh,rreth shkollave dhe te shtegu i ecjes ne kemi trupa ndriçues me rrezikshmëri të lartë të hapur, e pastaj të fillojmë me procedurat për ndriçim më të gjerë publik.

**Liridon Fandaj** - drejtor te punimet që janë bërë,ata veq i kanë vendos ato por gjendja nuk është kthyer në gjendjen e mëparshme dhe dy prerje të asfaltit i kanë bërë dhe ato janë të hapura ashtu.

**Amir Hoxha** - ne shumë vonë e kemi vendos edhe një mbikqyrës prej drejtorisë tone sepse në ekip nuk ka pas mikqyrës prej komunës dhe besoj që tash kanë me marrë masa për me kthy në gjendjen e mëparshe sepse ashtu e kanë obligim me kontratë.

**Sanie Kuçi Rexhepaj** - njëra prej pyetjeve që deshta me drejtu e tha edhe Liridoni që ka të bëj me rregulloren për menaxhimin e mbeturinave.Kemi pa përmes rrjeteve sociale që është hap thirrja për konsulrim publik me 8 maj.Paqartësitë kanë fillu me faktin se ne e kemi mbajtur një mbledhje urgjente në kuvedn dhe është miratu rregullorja,por nuk paskemi qenë të njoftuar që ministria e ka kthy në rishqyrtim apo në çfarë forme e ka kthy,a mundeni me na sqaru?Nën kryetarja e potenco i që kanë qenë disa çështje që i ka kërku m'i rishiku ministry,cilat janë ato çështje? Në thirrjen që është bërë konsultimi public keni dhënë një link referees por kur e hap linkun është vetëm faqja e komunës dhe nuk ka të publikuar asgjë.Mirë është me na sqaru siq e tha edhe Liridoni,kur vini në pikën finale po e kërkon ndoshta votën tone por nuk po jeni me kohë bashkëpunues me kuvendin.Pyetje për Drejtorinë e Urbanizmit.Çka po ndodh me Zonën industrial në Duhël?A ka kontratë ende active?Në çfarë forme janë duke punu për shkak se në fund të mandatit të kaluar ne e kemi pas një pike të rendit të ditës që nuk patë kaluar për me e hap në shqyrtim publik planin rregullues për Zonën industrial në Duhël.

**Avni Bytyqi** - rregullorja ka kaluar në seane urgjente dhe ka shku në shqyrtim të ligjshmërisë në ministry.Ende pa u kthyer konfirmimi i ligjshmërisë,besoj që ju shefat e grupeve parlamentare keni pas një takim me Kryetarin e komunës dhe me kryeshefin ekzekutiv të ndërmarrjes publike për të cilat besoj që sipas informacionit jeni pajtu që do të fillojë procedura e ngritjes përsëri,e tarifës dhe kanë kërku me fillu përnjëherë procedurën,ende pa u kthyer konfirmimi i ligjshmërisë,mirëpo pas sqarimeve ligjore që unë i kam bërë,jemi dakordu pavarësisht a kthehet pozitiv apo negative,rregullorja ka pas me fillu plotësim-ndryshimin e çështjes së tarifave sa i përket ekonomisë familjare.Rregullorja është kthyer për tri gabime teknike që unë mund ti potencoj por në konsultim publik ne kemi me ju njoftu se për çfarë arsye është kthyer rregullorja në rishqyrtim.Kërkesa e ekzekutivit,e grupit punues dhe e kryeshefit ekzekutiv të ndërmarrjes Ekoregjioni është që tarifa për ekonomitë familjare të jetë 7.5€.Ne kemi vepru ashtu siç e kërkon rregullorja dhe e kemi thirr konsultimin publik në afatin e paraparë ligjor dhe njoftimi është publik,mirëpo Kryetari i komunës ka kërkuar që përmes zyrtarit përgjegjës për konsultime publike i cili është i përcaktuar me vendim të Kryetarit,t'ju ftojë edhe anëtarët e asamblesë she shpresoj se sot

ose së largu të hënën do t'ju bëj ftesë juve si anëtar të asamblesë për të marrë pjesë në takimin konsultativ për çështjen e projekt-rregullores.

**Sanie Kuçi Rexhepaj**-a është plotësim -ndryshim?

**Avni Bytyqi**- ska plotësim-ndryshim.Ne jemi në procedure të korigjimeve që ka kërku ministria dhe njëherit edhe rritjen e tarifave.Për deri sa rregullorja nuk merr plotshmëri,ajo më nuk mund të krijon efekt juridik.

**Sanie Kuçi Rexhepaj** - a ka me u shfuqizu rregullorja që është miratu?

**Avni Bytyqi**-jo nuk shfuqizohet.Ne e kemi bërë korogjimin dhe e kam publiku në faqe të komunës dhe unë e konsideroj që kanë qenë gabime teknike por megjithëatë edhe ne mund të gabojmë.

**Sanie Kuçi Rexhepaj** - the që e kemi marrë pajtimin edhe të shefave të grupeve por kjo nuk për shkak se grupi jonë nuk e ka dhënë miratimin për rritjen e tarifave për shkak se ne kemi pas propozimet tona të cilat I kemi paraqit në seancën urgjente.Ne kemi rekomandu që rritja të bëhet 6 euro por të paktën deri me 1 janar të vitit 2027 që rritjen prej 1.5 me mbulu komuna me subvencionim.

**Avni Bytyqi** - unë së paku kam informacione që jo që jan pajtu me miratu por kanë diskutu për këtë çështje dhe Kryetari propozon ndërsa çështja e vendimmarrjes është e gjithë anëtarëve të asamblesë a me votu për,kundër apo jo.

**Liridon Fandaj**-sa i përket takimit janë pajtu ose nuk janë pajtu,ajo është me inqizim dhe dihet kush është pajtu dhe kush nuk është pajtu.Rregullorja nëse është kthyer për korigjim,ne është dasht ta kemi një ftesë që edhe ne me kontribu në atë rregullore.Nuk duhet të thoni që jemi pajtu për rritje të tarifës sepse nuk jemi pajtu.Ne edhe herën e kaluar nuk jemi pajtu por e kemi votu për shkak të gjendjes që ka qenë por nuk jemi pajtu me 7.5. Nëse një rregullore kthehet edhe për gabime teknike,duhet të shfuqizohet njëherë.Ne nuk e kemi arsytimin e ministrisë a është gabim teknik ,a ka diçka më shumë.

**Avni Bytyqi** - për deri sa nuk e merr konfirmimin,ajo nuk prodhon efekt juridik.Një akt që nuk ka prodhu efekt juridik,si e shfuqizon?Ne si ekzekutiv kemi të drejtë me ndërhy deri sa nuk e merr konfirmimin e ligjshmërisë në ministry.

**Aziz Bytyqi**- për hir të së vërtetës ne kemi qenë në takim dhe jemi dakordu që të merremi seriozisht me këtë çështje pas elaborimit që e ka bërë kryeshefi dhe jemi pajtu me bisedu sepse jemi bindur që çmimi aktual që është nuk e mbulon koston e shpenzimeve.Pyetje për Drejtorin e Shërbimeve Publike.e kam një shqetësim të qytetarëve ku me këtë shqetësim është marrë edhe ish drejtori Enver Shabani por nuk është zgjidh si çështje.Është një kanalizim në Shirokë te lagjja Ndre Mjedja.Në atë lagje janë 5 shtëpi që nuk kanë kanalizim publik ndërsa kam shku te qytetari që ma ka shpreh shqetësimin.Shtëpinë e ka skaj rrugës.Ka plan urbanistik dhe të gjitha obligimet e kryera ndaj shtetit.Si e ke idenë me zgjidh këtë problem?

**Amir Hoxha**-pronari është Xhemajl Ndrecaj dhe e kam të qartë atë fenomen për kanalizimin e tij.Unë asnjë kubëz,asnjë asfalt nuk e kisha shtrur veq me kanalizime isha marrë sepse është problem imediat dhe ka problem shumë me kanalizim.Me këtë buxhet që unë e kam gjet,ka me u përpjek që me I coptu prioritetet sepse ne kemi problem edhe në Savrovë,në Bllacë,në Duhël e gjithëandej.

**Albulena Kokollari** - si asambleiste ndiej obligim të reagoj ndaj një praktike që po përsëritet në seancat e asamblesë,ka ndodh në seancat e kaluara,ndodhi edhe sot.Është e papranueshme që sa here një asambleiste apo një drejtoreshë kërkon fjalën,has në vonesa të marrjes së fjalës dhe ndërprerje pavarësisht që sot Kryesuesi ia dha fjalën drejtoreshës por drejtoresha mezi e mor fjalën për me fol.Kjo nuk është vetëm çështje procedurale por mbi të gjitha është çështje respekti,kulture institucionale.Ne si përfaqësuese,si gra,tregojmë vazhdimisht respekt duke e pritur radhën tone,duke mos ndërhyrë kur të tjerët janë duke folur dhe kërkoj që I njejtë standart të vlejë për të gjithë.Kërkoj nga të gjithë kolegët,veqnerisht nga burrat,pa dallim partie politike në këtë asamble që bashkarisht të tregojmë kulturë komunikimi,profesionalizëm dhe respekt të plotë ndaj çdo asambleiste apo drejtoreshë që e merr fjalën.Institucionet tona duhet të jenë shembull I barazisë dhe I dinjitetit për të gjithë.

**Aziz Bytyqi** -unë i kërkoja falje që e mora fjalën por unë u kyqa në debat dhe e ke të drejtë.Unë nuk pajtohem me atë pjesë sepse gjininë femërore gjithmonë e kemi respektu.Respekt keni gjithmonë.

**Albulena Kokollari**-apsolut nuk ishte për profin por ishte rastësi sepse unë këtë e kam shkruar prej se e kam kërku fjalën.Nuk jam duke bërë ligjeratë dhe në fillim e thashë që e ndiej për me reagu për ato që kanë ndodh në seancat e kaluara por edhe sot.

**Nexhat Ramadani**-kam dy kërkesa ose këshilla për Drejtorin e Shërbimeve Publike.Është një problem i trotuarit në rrugën Leshan-Topliqan,është një pjesë e ngushtë ku nuk ka trotuar dhe ka qarkullim shumë.Patën filluar në qeverinë e kaluar diçka me punu por ka qenë arsytimi që nuk po lëshojnë

pronarët. Unë mendoj që është një problem që ne duhet me marrë seriozisht dhe nëse është nevoja të ndahen mjete dhe të bëhet eksplorimi për shkak se unë kam informacione që edhe për rrugë tjera është duke u bë eksplorimi për një rrugë në fushë të Sopisë për Gjinoc. Mendoni që ta merrni seriozisht këtë sepse aty ka rrezik çdo ditë. E kemi një rrugë që është parapa në buxhet për fshatin Leshan, Shaban Gashi dhe unë kam reagu atëherë sepse është Shadan Gashi dhe është mirë me përmirësu, por kemi edhe segment në dy rrugë Bashkim Kabashi dhe një tjetër. Ato janë segment dhe tregon që janë rrugë të shkurta. Në këtë pjesë të këtyre dy rrugëve ka rrugë të cilat kanë emërtim, kanë shumë banor, shumë shtëpi. Kërkesa ime është dil në vendngjarje, analizo dhe vlerëso drejtë se cilat kanë prioritet.

**Amir Hoxha**-te pjesa e trotuarit Topliqan-Leshan nuk jam në ngjarje. Në kapitalet për këtë vit nuk e kam si emërtim por shofim me mundësitë buxhetore çka mund të bëjmë dhe sipas vlerësimit të situatës. Procedurat për inicimin e procedurave publike ka qenë kjo ku ne fillimisht kemi dal në teren me gjirhë ingjinerat tone dhe I kanë mat rrugët, I kanë formu paramasat pastaj janë kthi në teren, I kanë bërë kalkulimet sipas matjeve të rrugëve. P.sh. nëse në një fshat nuk kanë dal paratë për 8 rrugë të cilat janë planifiku, ne gjithmonë e kemi ftu kryesinë e fshatit dhe ia kemi lënë në dorën e atyre me vlerësu se cila është prioritet për këtë vit. Unë nuk kam pretendime për asnjë rrugë por mbetet në diskrecionin e kryesisë së fshatit që ti vendosin prioritet konform buxhetit.

**Nexhat Ramadani**-unë e kuptoj procedurën por aty nuk është e precizuar dhe është segment. Mos bazohi vetëm në kryesi të fshatit. Unë vetëm të kërkoj të dalësh dhe ta analizosh gjendjen.

**Flamur Bytyqi** -sa mjete i ka nda komuna qendrës Dua dhe në çfarë forme i ka nda?

**Nënkryetarja** - nuk kam informacion.

**Flamur Bytyqi** -është shqetëm prej banorëve që kalojnë nga rruga e fshatit Semetisht. Rruga është për keqardhje për shkak se edhe uji po mbidhet në njërin anë dhe po rrezikohet jeta e qytetarit. A mund ta shikosh mundësinë dhe me intervene në atë pjesë. Përveç rrugës është edhe ndriçimi public të cilën e kam ngrit si shqetësim herën e kaluar. Te çështja e kontratës për ndriçim public, sa është vlera e kontratës? A janë shpenzu mjetet dhe a janë përfundu ato punë qysh janë parapa në kontratë? Një informatë që e kam, si ka mundësi që ky operator që e ka marrë këtë kontratë vet e ka bërë studimin e fizibilitetit? Te rruga te shkolla 7 Marsi që lidhet me ambulatë, është kërkesë e banorëve dhe njerëzve që kalojnë aty, ku shpeshherë emergjenca bllokohet për shkak që rruga është shumë e ngushtë, vetëm një veturë e zë. Mua vet personalisht më ka ra me pa që emergjenca u blloku për shkak që dikush u ndal përpara. A ka mundësi në atë pjesë, rreth e rreth ambulatës, me bo një shenjzëzim.

**Amir Hoxha** – te Semetishti kemi problem sepse po flen ajo rrugë, pavarësisht që po punohet. E kemi llogarit me shtrë me zhavorr deri sa të stabilizohet në gjendje vet mirëpo kemi pak qalime te kompania e sanimet për shkak të ngritjes së çmimeve të tyre. Deri sa janë aloku mjetet nuk kemi mujt me I bo pagesë atyre dhe nuk kemi mujt me I detyru duke pas mirëkuptim për bizneset sepse ka kohë që nuk marrin mjete. Te kontrata e ndriçimit, muajin e ardhshëm i kalon kontrata. Unë kam thënë që do të shoh për me e shikëput atë kontratë dhe tashti pasi po përfundon, e morëm si sugjerim të zyrtarit të prokurimit që ju I keni ndërpre sasi të kontratës është kornizë me 30% plus-minus, le të vazhdon të shikëputet si e tillë ndësa ne tash si asamble bëjmë para në atë kod që i ka marrë përmbaruesi, mundemi me fillu me procedurat e inicimit për ndriçimin publik. Sa i përket fizibilitetit nuk e di a e ka bërë operatori ekonomikë por kam thënë që ka qenë si lloj të paramasës në emër të efikasitetit. Drejtori tutje jep sqarime.

**Flamur Bytyqi** - me sa e di unë kontrata ka qenë mbi 2 milion euro. Kjo a e ka përmbush kontratën?

**Amir Hoxha** - kontrata ka qenë 10 vjeqare. Kjo e ka përfundu ndriçimin publik, sipas raportit të menaxherit të kontratës i ka përfundu trupat ndriçues sasi të krejt dhe pjesë tjera që i ka pas në paramasë. I ka vendos në 5 objekte trupat ndriçues të brendshëm sepse kjo kontratë e nënkupton që krejt ndriçimi në institucionet publike të komunës m'u zëvendësu. Mirëpo ne këtu po e ndërprejmë sepse nuk po jemi të interesuar me i ndriçu shkollat sepse punohet kryesisht me një ndërrim dhe kosto të lartë të tyre dhe po e ndërprejmë me këtë sasi.

**Flamur Bytyqi** - çka nuk po pajtohem me kontratën që është bërë, është bërë një keqplanifikim, sepse ti e ke bo një kontratë për poqa efficient e realisht strukturën tjetër e ke pas tmerrësisht keq, po lidhem së pari prej rrugës në Semetisht që u bo. Kontrata nuk e ma mrri afatin kohor 10 vjeqar por janë shpenzu mjetet.

**Amir Hoxha** - janë shpenzu 70% të mjeteve. Me 30% mbrapa ne po e ndërpresim.

**Flamur Bytyçi** - shqetësimi im është te ai që e ka nënshkru kontratën,nuk është për ty.Te çështja e shenjzimit të rrugës së ambulantës.

**Amir Hoxha** - kam një kërkesë me ushtruesin e detyrës së gjimnazit sepse edhe ata kanë problem me parkingun e personelit.Kam një kërkesë që edhe atyre me ju bë një shenjzimit,p/sh. Prej ores 08:00 deri në oën 13 ose 15:00.E për këtë pjesë besoj që urbanizmi duhet me planifiku një çasje më të gjërë për urgjencën atje.

**Laureta Tafaj** - para dy muajsh në KPF kemi diskutu bashkë me Flamurin për linjën e autobusit prej Semetishtit në Suharekë dhe për ngritjen e çmimeve.E kemi bë edhe një ankesë te agjencioni i konkurrencës dhe ata kanë thënë që komuna duhet të meret me këtë.Atë ditë në KPF e keni thënë që të bisedoni.Qytetarët po e kërkojnë një sqarim nëse ke mundësi me ia dhënë.

**Kryesuesi** - te puna e çmimit operatorët kanë fillu dhe i kanë bë ngritjet në Prishtinë-Suharekë-Prizren kurse pjesa tjetër,operatori në këtë rast është një operator por nuk kam bisedu me të.

**Nënkryetarja** - mua më ka ardhë ai emaili prej autoritetit të konkurrencës të cilët kanë kërku takim dhe ka ardhë në DSHP dhe pastaj është bartë te unë emaili.Emailin e kam dërgu te Drejtori i Inspeksionit dhe Drejtori i Inspeksionit ka lënë takim por për cilën datë nuk e di saktë.

**Flamur Bytyçi** - këtë shqetësim edhe privatisht e kam pas prej studentave por edhe prej banorëve të fshatit Semetisht që tarifa është shumë e lartë.Bashkë me Mimosën ne e kemi thirr pronarin e kompanisë,kemi bisedu dhe ai ka dhënë disa arsyetime për shkak të rritjes së naftës dhe problem tjera.Ne me qytetarët që kemi bisedu jemi mundu me ia kthy të njejtën përgjigje.Mirë po unë jam i gatshëm me të gjithë prej jush,me ardhë edhe një here dhe me shku në takim,me fol për këtë çështje.Besoj që çmimi është shumë i lartë.

**Mimoza Bajraktari** - most ë harrojmë se ai e pat edhe një shqetësim tjetër,p.sh. te nxënësat ku me muaj të tërë nuk i paguajnë as mujoret.Ai ka thënë që atë rajon e mbaj vetëm mos me lënë anën time,përndryshe kurrfarë fitime nuk kam.Në bazë të asaj që tha,ai është i dëmtuar.

**Flamur Bytyçi** - çështjen e tarifës,a ka të bëj diçka komuna me këtë aspekt? Si mundet me rregullu?A mund ta mbajmë një takim me shoqatat?

**Kryesuesi** - asnjëherë s'ka pas.Kjo ka qenë gjithmonë në domenin e shoqatave. Për momentin nuk ka as shoqatë në Suharekë

**Urim Suka** - një prej problemeve që mua më vjen turp nga vetja,dje kam qenë te lagjja Zekolli ku është me vite një kanalizim aty dhe është më shumë se urgjente me intervenu aty.Edhe te lagjja Shelqet kam qenë dhe e kam pa bllokimin e kanalizimit atje.Kam shku edhe te Hidroregjioni,ata kanë ardhë me shiku dhe kanë thënë që nuk është problem i joni por është problem i komunës.E kam ngrit para dy apo tre muajve dhe Kryetari është zotu që sapo të vjen kontrata kemi me bo diçka me problemin e kanalizimit në Bllacë.Dua ta di drejtori a e ka në planet e tyre sapo të bëhet kontrat me zgjidh këtë problem.Unë e kam njoftu drejtorin që ka një muaj që ndriçimi publik në Bllacë dhe Duhël në disa pjesë është edhe ditën edhe natën,nuk ndërprehet.A do të ndalet apo jo sepse është keq m'u bë shpenzim pa nevojë.Rrugën në Duhël dhe kanalizimin e përmendi Jehona dhe e përendi edhe drejtori që e ka me prioritet.Ajo është bë e pakalueshme dhe kanalizimi del aty.Rruga që lidh fshatin Sllapuzhan dhe Peqan,aty te varrezat vitin e kaluar është bë hapja e rrugës dhe është shtru me zhavorr.Dua ta di se me çfarë kodi është pagu ajo punë që është bë dhe a ka me vazhdu?Në planifikime nuk e kam pa.Edhe vite më herët është nis një rrugë që e lidh Sllapuzhanin me Bllacën,është bë një pjesë asfalt,është ndërpre dhe më s'është as pjesë e planifikimit.A ka mundësi edhe kjo me u bë? Drejtoreshën e Shëndetësisë e ndëgjova me vëmendje për mos zgjidhjen e drejtorit ku tha që nuk po konkurojnë dhe tha që drejtori duhet me qenë specialist i mjekësisë familjare.Zëvendësdrejtori a duhet me qenë specialist për me marrë detyrën apo është ndonjë procedurë tjetër?

**Kymete Bajraktari** - për zëvendësdrejtorin unë me sa e di ka qenë nëpër procedura dhe është në rregull.Nuk specifikohet.

**Amir Hoxha** - për rrugët Sllapuzhan,Peqan dhe Bllacë tani po ndëgjoj.As nuk i kam në kapitale,as nuk e di çka ka ndodh.Kanalizimi te Zekollët kur ke dal ti në fotografi,unë kam qenë ndoshta një javë përpara.Isha me inxhinierin që e ka punu një pjesë tjetër aty dhe më tha që kemi gjet shumë mbeturina.E kemi trajtu këtë pjesë,nuk ka pas probleme atëherë dhe tash janë shfaq problemet dhe është emergjente.Këtë javë që shkoi kemi bërë pagesën e fundit për kontratën e kaluar të kanalizimit.Tash po punojnë inxhinierët paramasën për sanimin e këtyre kanalizimeve për këtë vit e cila kontratë i ka 200 mijë euro.Ne do të mundohemi me i sanu dhe prioritet e kemi një lagje në Savrovë që është përmbyt pothuaj prej kanalizimit që e kanë ndërpre disa banorë tjerë,çështje mosmarrëveshje mes vete.E kemi

në Duhël,në Sllapuzhan ,në Suharekë te Bajraktarët dhe te Shelqet ku ka intervenu Hidroregjioni,nuk ka mujt me kry punë dhe tash ne duhet m'u qas me këtë kontratën e re për problemet që i kemi identifikuar si më prioritare.Sa i përket ndriçimit public në Duhë,është për shkak të një senzori,e kemi adresu këtë problem dhe besoj i vjen fundi dhe fillojmë me kontratë të re.

**Urim Suka** - te pjesa e rrugës Sllapuzhan-Peqan dhe Sllapuzhan-Bllacë,unë dua ta di për deri sa u nis,a është në planet me u kry në të ardhmen?Edhe te pjesa e Sllapuzhan-Peqan vitin e kaluar është shtruar dhe e kam pa që në panifikime nuk figuron.Dua ta di,nëse është në planet e tua me qel atë rrugë dhe me bo kubëza ose asfalt por nëse është bërë për fushatë dhe se ka as idenë me ditë,ti nëse nuk ke informatë,të lus të marrësh informata se çka ka ndodh dhe a doni me fut në planet afatgjata.

**Amir Hoxha** - unë këtë nuk e di por ne si drejtori nuk e kemi në planifikim fare dhe do ta gjej si informatë.

**Mimoza Bajraktari** - përmende kanalizimin te Bajraktarët dhe shqetësimi im është që pjesa poshtë që janë ndërtu shtëpi të reja,ata nuk kanë kanalizim.A është ndonjë planifikim për m'u bë?

**Amir Hoxha** - ne së pari kemi me i trajtu çështjet imediate,që janë kanalizime që kanë dal në sipërfaqe,pastaj kemi shqetësimin e profes sepse ai s'ka fare kanalizim.Me këtë buxhet çka të arrijmë kemi me bo,përveq sanimeve imediate kemi me i adresu sipas shkallës së prioriteteve që kan.

Takimi përfundoi: 14:35

Procesmbajtësja:Dafina Haziraj